

RAPORTI I BB-së

KLIMA E BIZNESIT, SHQIPERIA
PERMIRESOHET ME 32 VENDE

► F15



KLAJDA GJOSHA

GREQIA ASNJEHERE PROBLEM
PER INTEGRIMIN SHQIPERISE

► F6



[SHQIPTARJA.com]



ÇMIMI 30 LEKË

VITI VI - NR. 254

E MËRKURË, 26-10-2016

www.shqiptarja.com



KOKAINA TEK PULAT, NE KERKIM BIZNESMENI

Misteri i firmës që kishte
porositur mallin nga
Brazil. Policia po heton
për porositësin që priste
drogën në Durrës

► F13



ENERGJIA

Familjet në nevojë,
reduktim ose zerim
kamatah abonentëve

► F15

NGRIN VETINGU SKENARI I PD TESHTYJE LIGJIN PAS 2017

Gjykata Kushtetuese bllokoi ligjin e Vetingut
dhe e dërgon në Venecia. Komisioni u shpreh
në mars: Skema jep garanci për gjyqtarët dhe
prokurorët, mbron Shqipërinë nga korrupsioni.
SHBA-BE: Të mos vonohet dërgimi në Venecia

► FAQE 2-3



PËRGJIMET

Gjyqtari Doda:
S mund t'i jap
atij 2 mln euro
me 10 mln lekë

► F5



5-VJETORI

Dosja e pezulluar,
SHISH dhe
policia harrojnë
Isa Çopën

► F14



DORËHEQJA

Kushtetuesja në
ngërç largohet
gjyqtari
Sokol Berberi

► F4

Skenar shtyrje pas 2017, Venecia pro ligjit

Venecia: Vetingu i nevojshëm për të mbrojtur Shqipërinë nga korrupsioni, skema jep garanci për gjyqtarët dhe prokurorët

ADRIATIK DOÇI
TIRANE


Fondi kundër Reformës në Drejtësi në Shqipëri ka marrë dje një trajtë të plotë. Armatës së prokurorëve dhe gjyqtarëve, Partisë Demokratike dhe Presidentit të Republikës, i është bashkuar dhe Gjykata Kushtetuese, në kundërvënje të hapur ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë, disa vendeve të tjera të BE dhe shumicës së shqiptarëve, të cilët janë pro Reformës në Drejtësi, pro Vetingut dhe përmbyesjes së sistemit aktual. Ky front, me anë të Gjykatës Kushtetuese, ka mundësuar dje pezullimin, për një kohë të pacaktuar, të ligjit të Vetingut, duke u dhënë një frymëmarrje, jo vetëm gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar, por edhe politikanëve, të përfshirë në praktika korruptive. Në të njëjtën kohë, linja anti-reformë po arrin të shtyjë Vetingun në kalendart greke, duke pamundësuar edhe zbatimin e ligjeve të tjera prioritare. Frika e gjyqtarëve nga kontrolli i trefishtë dhe risku i largimit nga sistemi ka fituar përkohësisht mbi presionin e amerikanëve, të cilët mbajnë vullën dhe autorësinë e hetimit të ligjit të Vetingut. Aktualisht Reforma në Drejtësi ka ngrirë.

SKENARI I PD

Meqenëse Komisioni i Venecias është shprehur një herë, madje në mënyrë shteruese, për çështjen e Vetingut, pas pezullimit të ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese, duket se fshihet skenari i Partisë Demokratike, për t'a shtyrë zbatimin e ligjit pas zgjedhjeve të 2017. Në kushtet kur, Komisioni i Venecias, ka konfirmuar kolonatin bazë të procesit të Vetingut, lëvizja e fundit e Gjykatës Kushtetuese duket se është një lojë e opozitës, në koordinim me një pjesë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe Presidentin, për t'u fituar kohë. Që Komisioni i Venecias të shprehet, qoftë edhe duke refuzuar shqyrtimin e ligjshmërisë së ligjit, duhet të paktën dy muaj. Disa muaj do t'i duhen për t'u shprehur edhe Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, opozita dhe Presidenti mundësojnë zvarritjen e zbatimit të ligjit deri në prag të zgjedhjeve të 2017 apo edhe deri pas zgjedhjeve të 2017, me shpresën e ndryshimit të raporteve politike në parlamentin e ardhshëm. Siç dihet, opozita është shprehur hapur kundër rolit të Drejtorisë së Pastrimit të Parave, IL-DKP dhe DSK në kontrollin e pasurive dhe të figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, me pretendimin se, këto organe varen nga qeveria dhe si të tilla mund të përgatisin raporte negative kundër gjyqtarëve, të konsideruar pranë PD.

VENECIA PËR VETINGUN

Kryefjala e vendimit të djeshëm të Gjykatës Kushtetuese është dërgimi për interpretim i ligjit të Vetingut në Komisionin e Venecias, për t'u shprehur në lidhje me papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Por, në 14 Mars të vitit 2016, Komisioni i Venecias, në opinionin përfundimtar për projektin Kushtetues, është shprehur



Vërejtjet

Në opinion, Komisioni i Venecias jep sida sugjerime dhe vërejtje, të cilat në përgjithësi janë reflektuar në projektin Kushtetues dhe ligjin e Vetingut, ndërsa nuk përkohet me pretendimet e Partisë Demokratike.

gjerësisht për çështjen e Vetingut. Në faqen 13 të opinionit, Komisioni i Venecias i konsideron të nevojshme masat e jashtëzakonshme për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Komisioni thotë se skema e vlerësimit jep garanci për gjyqtarët dhe prokurorët. "Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për të vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët, Komisioni i Venecias është i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikueshme, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor. Projekt ndryshimet e rishikuara marrin parasysh kritikën që ka bërë Komisioni në Opinionin e Ndërmjetëm. Varianti i ri i Aneksit është shkruar në mënyrë më të saktë dhe shumica e sugjerimeve të Komisionit të Venecias janë marrë parasysh. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi."

Skenari

Në kushtet kur, Komisioni i Venecias, ka konfirmuar kolonatin bazë të procesit të Vetingut, parashikuar në Kushtetutë, lëvizja e fundit e Gjykatës Kushtetuese duket se është një lojë e PD, gjyqtarëve, prokurorëve dhe Presidentit, për të fituar kohë.

sionit të Venecias janë marrë parasysh. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi", thuhet në opinionin e Komisionit të Venecias.

KRITIKA

Komisioni i Venecias ka theksuar domosdoshmërinë e të drejtës së gjyqtarëve për të apeluar vendimet e institucioneve të vlerësimit. E drejta e apelit përmban edhe thellën opinionin të Venecias për çështjen e Vetingut. Dhe propozimi është reflektuar në Kushtetutën e Re. Pika 5 e nenit, 179/b të Kushtetutës parashikon që rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolege.



NJOFTIM PËR MEDIAN

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është mbledhur në datën 26.10.2016.

Kërkesa: 1/5-ta e Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë - Demokratike

Subjekte të interesuara: Kuvendi i Shqipërisë

Objekti: Deklarimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën e ligjit nr.8 kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Pezullimi i ligjit nr.84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin ka Republikën e Shqipërisë".

Baza ligjore: Nenet 4, 7, 17, 32, 42, 49, 78, 124, 125, 131/a, 131/b, 131/c, 131/d, 131/e, 131/f, 131/g, 131/h, 131/i, 131/j, 131/k, 131/l, 131/m, 131/n, 131/o, 131/p, 131/q, 131/r, 131/s, 131/t, 131/u, 131/v, 131/w, 131/x, 131/y, 131/z, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 382, 383, 384, 385, 386, 387, 388, 389, 390, 391, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 401, 402, 403, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 431, 432, 433, 434, 435, 436, 437, 438, 439, 440, 441, 442, 443, 444, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517, 518, 519, 520, 521, 522, 523, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 532, 533, 534, 535, 536, 537, 538, 539, 540, 541, 542, 543, 544, 545, 546, 547, 548, 549, 550, 551, 552, 553, 554, 555, 556, 557, 558, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 569, 570, 571, 572, 573, 574, 575, 576, 577, 578, 579, 580, 581, 582, 583, 584, 585, 586, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 593, 594, 595, 596, 597, 598, 599, 600, 601, 602, 603, 604, 605, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620, 621, 622, 623, 624, 625, 626, 627, 628, 629, 630, 631, 632, 633, 634, 635, 636, 637, 638, 639, 640, 641, 642, 643, 644, 645, 646, 647, 648, 649, 650, 651, 652, 653, 654, 655, 656, 657, 658, 659, 660, 661, 662, 663, 664, 665, 666, 667, 668, 669, 670, 671, 672, 673, 674, 675, 676, 677, 678, 679, 680, 681, 682, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 689, 690, 691, 692, 693, 694, 695, 696, 697, 698, 699, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 708, 709, 710, 711, 712, 713, 714, 715, 716, 717, 718, 719, 720, 721, 722, 723, 724, 725, 726, 727, 728, 729, 730, 731, 732, 733, 734, 735, 736, 737, 738, 739, 740, 741, 742, 743, 744, 745, 746, 747, 748, 749, 750, 751, 752, 753, 754, 755, 756, 757, 758, 759, 760, 761, 762, 763, 764, 765, 766, 767, 768, 769, 770, 771, 772, 773, 774, 775, 776, 777, 778, 779, 780, 781, 782, 783, 784, 785, 786, 787, 788, 789, 790, 791, 792, 793, 794, 795, 796, 797, 798, 799, 800, 801, 802, 803, 804, 805, 806, 807, 808, 809, 810, 811, 812, 813, 814, 815, 816, 817, 818, 819, 820, 821, 822, 823, 824, 825, 826, 827, 828, 829, 830, 831, 832, 833, 834, 835, 836, 837, 838, 839, 840, 841, 842, 843, 844, 845, 846, 847, 848, 849, 850, 851, 852, 853, 854, 855, 856, 857, 858, 859, 860, 861, 862, 863, 864, 865, 866, 867, 868, 869, 870, 871, 872, 873, 874, 875, 876, 877, 878, 879, 880, 881, 882, 883, 884, 885, 886, 887, 888, 889, 890, 891, 892, 893, 894, 895, 896, 897, 898, 899, 900, 901, 902, 903, 904, 905, 906, 907, 908, 909, 910, 911, 912, 913, 914, 915, 916, 917, 918, 919, 920, 921, 922, 923, 924, 925, 926, 927, 928, 929, 930, 931, 932, 933, 934, 935, 936, 937, 938, 939, 940, 941, 942, 943, 944, 945, 946, 947, 948, 949, 950, 951, 952, 953, 954, 955, 956, 957, 958, 959, 960, 961, 962, 963, 964, 965, 966, 967, 968, 969, 970, 971, 972, 973, 974, 975, 976, 977, 978, 979, 980, 981, 982, 983, 984, 985, 986, 987, 988, 989, 990, 991, 992, 993, 994, 995, 996, 997, 998, 999, 1000.

DISA NGA KONSTATIMET DHE VËREJTJET E KOMISIONIT TË VENECIAS PËR VETINGUN

Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për të vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët, Komisioni i Venecias është i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikueshme, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor.

Projekt ndryshimet e rishikuara marrin parasysh kritikën që ka bërë Komisioni në Opinionin e Ndërmjetëm. Varianti i ri i Aneksit është shkruar në mënyrë më të saktë dhe shumica e sugjerimeve të Komisionit të Venecias janë marrë parasysh. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi.

Komisioni i Venecias rekomandon që të shkurohet ndjeshëm kohëzgjatja e procesit të vlerësimit. Do të ishte e dëshirueshme të vendosej një afat i prerë prej rreth 3 - 5 vjetësh brenda të cilit do të ekzistonte KPK-ja dhe DSK-ja.

Gjithashtu, për të vlerësuar dhe ri-vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, sidomos dispozitave në lidhje me privatësinë, është i kufizuar në përputhje me nenin 17 të kësaj Kushtetute. Këto masa mund të justifikohen me situatën aktuale të gjyqësorit shqiptar, i cili kërkon ndërhyrje të vegantë ligjore.

Në lidhje me përzgjedhjen paraprake të kandidatëve, pranohet që Avokati i Popullit i Shqipërisë të zhvillojë një proces aplikimi të hapur dhe transparent për anëtarët e KPK, gjyqtarët e DSK dhe Komisionerët publik. Komisioni vëren me keqardhje që § 127 i Opinionit të Ndërmjetëm është interpretuar si miratim i mendimeve të shkrehura nga disa anëtarë të opozitës në lidhje me afërsinë e dyshuar të Avokatit të Popullit me qeverisjen aktuale.

Komisioni i Venecias gjithashtu ka argumentuar vazhdimisht në favor të mundësisë së ankimit në gjykatë të një vendimi të organeve disiplinore.

Mund të ishte parashikuar mundësia e DSK për të rishikuar jo vetëm vendimet përfundimtare të KPK për themelin, por edhe vendimet procedurale të ndërmjetme (sidomos ato në lidhje me marrjen e provave).

Vëzhguesit ndërkombëtar duhet të kenë kompetencë për të ankuar kundër këtyre vendimeve procedurale përpara DSK.

DSK mund të korrigjojë gabime procedurale të KPK por nuk ka kompetencë që ta kthejë çështjen për korrigjim të një vendimi. I është dhënë kompetencë e shprehur për të miratuar ose ndryshuar një vendim.

REAGIMI

SHBA-BE: Jemi të përkushtuar për zbatimin e reformës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për të pezulluar ligjin e Vetingut. Me anë të një deklarate për shtyp, thuhet se SHBA dhe BE mbeten të përkushtuara për zbatimin e plotë të reformës së gjyqësorit. Në deklaratë thuhet gjithashtu se Gjykata Kushtetuese t'a referojë sa më shpejt ligjin në Komisionin e Venecias. "Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian respektojnë autoritetin e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar Ligjin e Vetingut dhe pezulluar zbatimin e tij. Gjykata Kushtetuese ka thënë se do t'a referojë ligjin Komisionit të Venecias. Nxism që ky referim të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur për të parandaluar vonesa. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian mbeten të përkushtuar ndaj zbatimit të plotë të reformës së gjyqësorit", thuhet në deklaratë.



Spartak Ngjela

KOMENTI

Ngjela: Kushtetuesja kukull e Saliut

Avokat Spartak Ngjela ka komentuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të çuar ligjin e Vetingut në Komisionin e Venecias. "Gjykata Kushtetuese, u tremb më shumë nga historia dhe politika amerikane, se nga krimi aktual shtetëror, dhe e çoi Vetingun në Komisionin e Venecias... Të gjithë këto hordhi korruptive sot të mbrojtura

hapur nga Sali Berisha dhe kukullat e tij, në fakt si mbrojtës të pronave të grabitura pronarëve të ligjshëm me forcën e shtetit: sipas të dhënave që kanë ndërkombëtarët, familja e Sali Berishës, direkt dhe me emra të tjerë, disponon aktualisht me mijëra hektarë tokë. Kot mundohet me Gjykatën Kushtetuese", shkruan Ngjela.

NENKRYETARI PD-së

Oerd Bylykbashi: Vetingu nuk zbatohet

Nenkryetari PD-së në komisionin e Reformës në Drejtësi, Oerd Bylykbashi, ka theksuar dje se ligji i Vetingut nuk mund të zbatohet, pas vendimit të Kushtetueses për ta pezulluar. "Ky ligj për momentin nuk mund të zbatohet deri në një vendim përfundimtar. Nëse ky ligj do të zbatohet do të kishte pasojë të pakthyeshme. Largimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar duhet të bëhet vetëm sipas standardit kushtetues dhe jo atij të Kryeministrit Rama që me Vetingun kërkon kapjen e drejtësisë", tha Bylykbashi.



Oerd Bylykbashi

VENDIMI I KUSHTETUESËS

1. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Kërkimin e amicus curia nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Pranimin e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë për të marrë pjesë në gjykim si subjekt i interesuar.

Kushtetuesja "ngrin" Vetingun, pezullohen procedurat e kontrollit

ADRIATIK DOÇI
TIRANË

Rikthehet përkohësisht qetësia në sistemin e drejtësisë. Pezullohet çdo lëvizje dhe procedurë për zbatimin e ligjit të Vetingut. Në konflikt flagrant interesi, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, ka vendosur dje të "ngrijë" një nga ligjet më të rëndësishme të Reformës në Drejtësi, pikërisht ligjin e Vetingut, i cili parashikon të kalojë në skenar të trefishtë rreth 800 prokurorë dhe gjyqtarë, për ligjshmërinë e pasurive, lidhjet me krimin dhe aftësitë profesionale. Në një kohë rekord pas kërkesës së Partisë Demokratike, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë mbledhur dje në dhomën e këshillimit, duke vendosur pezullimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas burimeve, seanca ka qenë e tensionuar, ndërsa ka zgjatur dy orë.

VËNIA NË LËVIZJE E VENECIAS

Kushtetuesja ka vendosur t'i drejtohet Komisionit të Venecias, për t'u shprehur mbi pajtueshmërinë e ligjit me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Shqipërisë. Vetëm 20 ditë pas kërkesës së opozitës dhe në një kohë kur institucionet kishin nisur zyrtarisht lëvizjet për zbatimin e ligjit të Vetingut, Kushtetuesja ka pezulluar ligjin, duke "ngrirë" kështu çdo procedurë. "Pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e

Qetësohen gjyqtarët e korruptuar, Gjykata Kushtetuese çon Vetingut në Venecia, vendimi në konflikt interesi

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendosi: Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe proku-

rorëve në Republikën e Shqipërisë". Kërkimin e amicus curia nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin

kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pranimin

Bllokimi nga Nishani

Kreu i shtetit refuzoi të zbatonte ligjin e Vetingut. Nga ana tjetër, krerët e ILDKP dhe DSIK firmosën urdhrat për procedurat e kontrollit të pasurive dhe kontrollit të figurës.



KONFLIKTI I INTERESIT, NENI 4 I LIGJIT TË VETINGUT

3. Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kur çështja është gati për t'u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm.

4. Çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm do të trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit.

Vendimi

"Në konflikt flagrant interesi, Gjykata Kushtetuese, ka vendosur dje të "ngrijë" një nga ligjet më të rëndësishme të Reformës në Drejtësi, pikërisht ligjin e Vetingut, i cili parashikon të kalojë në skenar të trefishtë rreth 800 prokurorë dhe gjyqtarë".

e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë për të marrë pjesë në gjykim si subjekt i interesuar", thuhet në njoftim.

KONFLIKTI I INTERESIT

Gjykata Kushtetuese ka pezulluar dje ligjin e Vetingut në konflikt flagrant interesi. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë njerëzit e parë të drejtësisë, objekt i veprimtimit të ligjit të Vetingut, ku duhet t'i nënshtrohen skanerit të trefishtë, për ligjshmërinë e pasurive, lidhjet me krimin dhe aftësitë profesionale. Në pikën katër të nenit 4 të ligjit për Vetingun, thuhet se çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm do të trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit. Pra, Kushtetuesja u shpreh dje për një ligj që parashikon kontrollin e trefishtë të anëtarëve të saj si dhe vendosjen e fatit të mandatit të tyre, në bazë të rezulttit të kontrollit.

PRESIDENTI BLOKOI LIGJIN

Edhe pse i detyruar me ligj, kreu i shtetit vendosi të mos i hapë rrugë zbatimit të menjëhershëm të ligjit të Vetingut. Neni 7 pika 1 i ligjit parashikonte që Presidenti i Republikës shpallte menjëherë thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit në fagen zyrtare të internetit, si dhe në dy gazeta me tirazhin më të lartë në vend. Institucionet e rivlerësimit janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe komisionerët publikë. Me sa duket, Nishani e ka pritur vendimin e Kushtetueses. Nga ana tjetër, krerët e ILDKP dhe DSIK firmosën urdhrat për procedurat e kontrollit të pasurive dhe kontrollit të figurës.



Ngërci

Nga nëntë anëtarë gjyqtarët kushtetuese mbeten 8 dhe në rast të një vendimmarrje 4 pro e 4 kundër për çështje të cilat gjykohen në këtë gjykatë atëherë nuk mund të merret një vendim



Mandati

Sokol Berberit i kishte mbaruar mandati si anëtar i Gjykatës Kushtetuese që në muajin prill 2016. Megjithatë ai kishte vazhdua të qëndronte në detyrë deri në muajin shtator, kur edhe dha dorëheqjen

Arsvetimi

Pas përfundimit të këtij afati gjyqtari duket parë mungesën e vullnetit nga institucionet e ngarkuara për përzgjedhjen e anëtarit zëvendësues vendosi të dorëhiqet

Kushtetuesja në ngërç, largohet gjyqtari Sokol Berberi

I kishte mbaruar mandate prej 6 muajsh jep dorëheqjen e parevokueshme

Dorëheqja e parevokueshme e gjyqartar kushtetues Sokol Berberi për shkak të mbarimit të mandatit të tij pritet të fusë në ngjerc Gjykatën Kushtetuese. Kjo pasi nga nëntë anëtarë gjyqartar kushtetues mbeten 8 dhe në rast të një vendimmarrje 4 pro e 4 kundër për çështje të cilat gjykojnë në këtë gjykatë atëherë nuk mund të merret një vendim.

Vendimi sipas ligjit për funksionimin e gjykatës kushtetuese merret me shumicë anëtarësh apo me vetëm një votë diferencë por në situ-

atën e re të krijuar nëse 4 anëtar janë pro e 4 kundër praktikisht gjykata kushtetuese bllokohe. Sokol Berberi normalisht do duhet të qëndrojë në detyrë deri në zgjedhjen e zëvendësuesit të tij por ajo kaçibie në sy nga kjo dorëheqje është fakti se në faqen zyrtare të gjykatës Kushtetuese tek rubrika anëtarët profile i

Berberi është hequr dhe aty rezultojnë vetëm 8 anëtarë. Kujtojmë që Sokol Berberi ishte njëri nga tre kandidatët për në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, por që nuk u pranua.

**PSE U LARGUA
TANI GJYQTARI**

Sokol Berberi i kishte

mbaruar mandati si anëtar i Gjykatës Kushtetuese që në muajin prill 2016. Megjithatë ai kishte vazhduar të qëndronte në detyrë deri në muajin shtator, kur edhe dha dorëheqjen. Por, pse gjyqtari Berberi vendosi në këtë moment që të largohej. Sipas burimeve pranë gjyqtarit ai në

respekt të Kushtetutës dhe ligjit që përcakton se gjyqtari që i ka mbaruar mandatin duhet të qëndrojë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarit zëvendësues, Berberi qëndroi 6 muaj si pjesë e kësaj gjykatë deri ditën që vendosi të dorëhiqej. Pas përfundimit të këtij afati gjyqtari duhet parë

mungesën e vullnetit nga institucionet e ngarkuara për përzgjedhjen e anëtarit zëvendësues vendosi të dorëhiqet.


VLADIMIR KRISTO

Edhe një tjetër anëtar i të Gjakatës Kushtetuese, Vladimir Kristo prej muajit prill 2016 i ka mbaruar mandatin. Por ai vijon të qëndrojë në detyrë me një argument krejt ndryshe nga Sokol Berberi. Gjyqtari Kristo refuzon të japë dorëheqjen pasi sipas tij: “Kushtetua më detyron të qëndroj në detyrë derisa të emërohet anëtar i zëvendësues”.

GJYOI

Korrupsioni, ja kush do gjykojë gjyqtaren Majlinda Andrea

Artan Zeneli, Shkelzen Selimi, Ardian Dvorani, Mehdi Bici dhe Evelina Qirjako si relatore e cështies janë 5 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të



Ku e perishte rezultoni
dhe gjyqtarja Andrea. Ndërkohë po në këtë
gjykatë rezultoi se është depozituar kërkesa e
bashkëshortit të gjyqtarës Andrea, Odhise An-
drea për të ndryshuar masën e sigurisë arrest
me burg që rëndon ndaj tij. Në kërkesën e tij
drejtuar gjykatës Odhise Andrea kërkon heqjen
e arrestit me burg dhe po ashtu heqjen e masës
së kërkitim policorë vendosur ndaj tij.

PEZULLIMI I VETINGUT

Mediat e huaja: Do të bllokojë Reformën në Drejtësi

Pezullimi i ligjit të Vetingut nga Gjykata Kushtetuese në Shqipëri është pasqyruar duke bërë jehonë edhe në mediat ndërkombëtare, të cilat e cilësojnë si zvarritje të Reformës në Drejtësi. "The New York Times" shkruan se pezullimi i ligjit më të rëndësishëm të Reformës në Drejtësi do të bllokojë nisjen e procesit për kontrollin e gjyqtarëve dhe Edhe AP me "Fox News" i kushtuar rëndësi duke e pasqyruar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Sipas tyre dërgimi i ligjit në Komisionin e Vencias është zvarritje, pasi është shprehur një herë për këtë paketë që u miratua nën kujdesin e BE dhe SHBA. Pezullimi i ligjit, vjen vetëm pak ditë para vendimit të progres raportit ku Shqipëria shpreson për hapjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian.



VETINGU

Braçe: Vendimi ulëritës, po vjen radha e 21 Janarit dhe Gërdecit!

I fortë ka qenë reagimi i deputeti i PS, Erjon Braçe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin për Ligjin e Vetëing. Në profilin e tij në facebook Braçe deklaroi se: "Vendimi i sotëm i Gjykatës Kushtetuese të bën të ulërsh, pasi sipas tij gjykatësit që me ligj, janë të parët në listë që duhet të rivlerësohen për pasurinë, lidhjet me krimin dhe aftësinë, vendosen në konflikt interesi që jo vetëm ata të mos rivlerësohen, por të gjithë prokurorët e gjykatësist aktualisht në sistem, të mos kontrollohen, përkohësisht". Por sipas, Braçes, asgjë nuk ndryshon. "Vetëm vonohet në kohë me shprehën unike të Sali Berishës dhe Bashës dhe jo vetëm, për të rrëzuar këtë qeveri dhe bllokuar gjithçka që ka lidhje me kontrollin e trefsishtë të prokurorëve e gjykatësive aktualisht në sistem", shprehet deputeti i PS-së. Braçe thotë se ky sistem është një biznes i keq, nuk jep drejtësi sipas kushtetues, por mundësinë kushtetuese për të dhënë drejtësi, e ka kthyer në një burim përfitimesh politike dhe pasurore, por sipas tij të gjithë do të gjykojnë duke filluar nga 21 Janari dhe Gërdëci.

Gjyqtari: S'mund t'i jap atij 2 mln euro se jep ai 10 mln lekë

Përgjimi i gjyqtarit Rasim Doda, avokatit: Ti je përgjegjësi. Biznesmeni: Më more në qafë

ELTON QYNO
TIRANE

Vetëm një ditë pas dënimit të gjyqtarit të Sarandës Rasim Doda me 4.6 vite burg, zbardhen bisedat dhe sms e këmbryera mes Dodës, kallëzuesit Hasan Bushi dhe avokatit të këtij të fundit Flamur Lazaj. Në një bisedë me Lazaj, Rasim Doda, pranon që i janë ofruar 10 milion lekë, duke i pohuar se: "...përgjegjësia është mbi ty se nuk mund të tallet ai me mua, se unë nuk i jap atij dy milionë euro se don ai në kurriz të popullit, kundrejt dhjetë milion leksh dhe mbaje mend se në qoftë ti nesër nuk e zgjidh...". Kjo bisedë është dokumentuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe vetë në mbrojtjen prej 150 faqesh është pranuar dhe nga gjyqtari i pandehur Rasim Doda. Gazeta "Shqiptarja.com" zbardh të plotat dhe sms mes biznesmenit të subjektit "Kalaja T" Sh.p.k Hasan Bushi, ku ky i fundit në pamundësi për të paguar shifrën prej 80 mijë euro për garantimin e fitores në gjykatë, vendos ti nisi një sms gjyqtarit Doda, i cili po atë ditë i kishte dorëzuar dispozitivin e vendimit të gjykatës ku shpallje fitues Hasan Bushi, por gjithmonë në rast se ky i fundit do paguante shumën prej 80 mijë euro. Përmbajtja e sms që Bushi i dërgon gjyqtarit Doda është kjo: "...mos më merr në qafë kot, çdo muhabet e ke bërë me avokatit, bashkë komunikojmë dhe mirë është të nglemi miq për jetë. Hasan Bushi...". Këtë mesazh telefonik kallëzuesi ia ka dërguar dy herë gjyqtarit Doda, në orën 22:49 të 19 prillit 2015 dhe në orët e mesnatës 01:24 të 20 prillit.

DËMSPËRBLIMI 886 MILION LEKË

Në analizën e provave të administruara gjatë gjykimit të kësaj çështje penale u evidencua se i pandehuri Rasim Doda në cilësinë e gjyqtarit në gjykatën e Sarandës, ka kërkuar nga kallëzuesi Hasan Bushi, në formë përfundim të parregullt një shumë prej 80 mijë euro, me qëllim marrjen e vendimit në favor të kallëzuesit. Më konkretisht gjyqtari Rasim Doda, ka qenë duke gjykuar çështjen gjyqësore civile me palë kundërshtare shtetasen Gjinovëfa Shehu dhe shoqërisë "Kalaja T" Sh.p.k me përfaqësues ligjor shtetasin Hasan Bushi. Në datën 20 prill 2015 është shpallur vendimi gjyqësor përfundimtar lidhur me



Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë

DY HERË

Një mesazh telefonik kallëzuesi ia ka dërguar dy herë gjyqtarit Doda, në orën 22:49 të 19 prillit 2015 dhe në orët e mesnatës 01:24 të 20 prillit.

këtë çështje, me anën e të cilit është pranuar kërkesë padia e shtetasen Gjinovëfa Shehu dhe është rrëzuar kundërpadia e shoqërisë "Kalaja T" Sh.p.k. Mirëpo një ditë para shpalljes së këtij vendimi, në datën 19 prill 2015 në mbrëmje pas orës 20:00 kallëzuesi Hasan Bushi, ka qenë duke shkruar tek zyra e avokatit të tij Flamur Lazaj, ndërkohë është takuar në rrugë me të pandehurin Rasim Doda, i cili pasi i ka thurur në emër njëherësh i ka dhënë kallëzuesit një fletë të palosur, duke i

thënë se ky ishte vendimi për të nesërmen, pra në datën 20 prill kur ishte parashikuar të zhvillohej senca e fundit për dhënien e vendimit. Biznesmeni Hasan Bushi, ka hapur letërën e palosur, ku ishte shkruar dispozitivi i vendimit gjyqësor dhe ka lexuar që sipas atij vendimi ishte pranuar pjesërisht kundërpadia e tij dhe se përfitonte një dëmshpërblim në shumën prej 88.659.066 lekë të reja. Mirëpo në këtë moment gjyqtari Rasim Doda, i ka bërë me shenjë me dorë për ndonjë lekë, duke i bërë me shenjë në pëllëmbën e dorës që Hasan Bushi, i ka lënë të kup-tojë se gjyqtari kërkonte 80 mijë euro. Bushi i ka shprehur me gjehtë të pandehurit se nuk kishte para, ndërkohë gjyqtari pas këtij momenti është larguar, duke i bërë me shenjë me gjehtë se nuk kishte për ta fituar gjyqin dhe i ka lënë në dorë vetëm letërën A4, ku ishte shkruar dispozitivi i vendimit të përgatitur një ditë më parë.

DËMSPËRBLIMI


Biznesmeni Hasan Bushi, ka hapur letërën e palosur, ku ishte shkruar dispozitivi i vendimit gjyqësor dhe ka lexuar që sipas atij vendimi ishte pranuar pjesërisht kundërpadia e tij dhe se përfitonte një dëmshpërblim në shumën prej 88.659.066 lekë të reja.

EKSPERTIMI

Gjatë ekspertimit të kompjuterit dhe printerit në zyrën e gjyqtarit Rasim Doda është mësuar se ky i fundit kishte përpiluar dy vendimi gjyqësorë, ku në njërin kishte parashikuar dhënien e vendimit në favor të Hasan Bushit dhe në tjetrin në favor të Gjinovëfa Shehut.

MESAZH GJYQTARIT "MOS MË MERR NË QAFË"

Kallëzuesi Hasan Bushi më pas ka shkruar i shqetësuar në zyrën e avokatit të tij Flamur Lazaj, të cilit i ka treguar për takimin me gjyqtarin e çështjes dhe se ky i fundit i kishte kërkuar një shumë prej 80.000 euro me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor në favor të tij. Kallëzuesi i ka kërkuar avokatit numrin e telefonit të të pandehurit Rasim Doda dhe më pas i ka telefonuar disa herë, por i pandehuri nuk e ka hapur telefonin. Më pas, në orën 22:49 kallëzuesi i ka dërguar të pandehurit një mesazh telefonik duke i thënë se: "...mos më merr në qafë kot, çdo muhabet e ke bërë me avokatit, bashkë komunikojmë dhe mirë është të nglemi miq për jetë. Hasan Bushi...". Këtë mesazh telefonik kallëzuesi ia ka dërguar përsëri të



Rasim Doda

pandehurit edhe në orën 01:24 të datës 20.04.2015. Të nesërmen, më datë 20 prill 2015, Hasan Bushi, është telefonuar nga i pandehuri Rasim Doda, në orën 07:00, ndërsa në orën 10:57 kallëzuesi i ka dërguar të pandehurit një mesazh tjetër, me përmbajtje: "...mendoj se si malësor do ta mbash llafin. Nuk m'bahe besë. Ke nivelin e një mashtroesi. Mos më akuzo mua. Hasan Bushi". Po në të njëjtën ditë Rasim Doda ka shpallur vendimin gjyqësor, duke lexuar vetëm dispozitivin e vendimit, me të cilin ishte vendosur pranimi i padisë së paditëses Gjinovëfa Shehu dhe rrëzimi i kundërpadiës së shoqërisë "Kalaja T" sh.p.k. Ndërkohë gjatë ekspertimit të kompjuterit dhe printerit në zyrën e gjyqtarit Rasim Doda është mësuar se ky i fundit kishte përpiluar dy vendimi gjyqësorë, ku në njërin kishte parashikuar dhënien e vendimit në favor të Hasan Bushit dhe në tjetrin në favor të Gjinovëfa Shehut.

"DO LEKË NË KURIZ TË POPULLIT"

Nga bisedat e përgjimit ambjental të kryer midis Hasan Bushit dhe të pandehurit Rasim Doda të kryer në datën 23 prill 2015 konstatohet fakti se në këtë moment, tre ditë pas shpalljes së vendimit, dosja gjyqësore civile ndodhej ende në zyrën e gjyqtarit dhe se deri në këtë moment dosja dhe vendimi i arsyetuar nuk ishte dorëzuar në sekretari. Në këtë bisedë kallëzuesi Hasan Bushi i bën të ditur disa herë të pandehurit Rasim Doda se ai kishte shpallur dhe i kishte dorëzuar në dorë një tjetër vendim. Por gjyqtari Rasim Doda, është mjaftuar vetëm me përgjigjen: "...se ky është vendimi që ka shpall zyrtarisht gjykata...". Po kështu në të njëjtën ditë gjyqtari Rasim Doda ka telefonuar avokatit Flamur Lazaj duke i thënë se: "...përgjegjësia është mbi ty, se nuk mund të tallet ai me mua, se unë nuk do ti jap atij dy milion euro, se don ai në kurriz të popullit kundrejt 10 milion leksh dhe mbaje mend se në qoftë se ti nesër nuk e zgjidh...".

TREGU INTELEKTUAL

Të drejtat e autorit, hyn në fuqi ligji i ri

Ka hyrë dje në fuqi ligji për të drejtën e autorit, një ligj kyqës që është miratuar që në muajin mars të këtij viti. Ligji shënon një ndryshim të rëndësishëm në mbrojtjen e të Drejtës së Autorit, duke u rënditur kështu në një hap me legjislacionet më të avancuara në Europë për këtë fushë. Ligji i ri mbron dhe garanton një kategori vullnetar që është ajo e krijuesve që asnjëherë s'kanë përfutur mbrojtjen e merituar dhe njohjen me të drejta të plota të së drejtës së vet të pronësisë intelektuale. Ky

ligj i njeh, mbron dhe garanton autorëve, mjedis të sigurt dhe mundësi për të përfutur nga puna e veprave të tyre. Autori e gjen veten të mbrojtur në këtë ligj, sidomos për garancitë ligjore që i jep, çka bën që tregu intelektual të funksionojë në interes të krijuesve dhe të jetë dokumenti bazë për të shtrirë dhe zhvilluar veprimtarinë e tyre krijuese. Ka filluar miratimi i akteve nënligjore të këtij ligji, të cilat do të japin efektet e para pozitive drejt standartzimit të tregut shqiptar me atë evropian. Edhe



ky proces u është nënshtruar konsultimeve të gjera me grupet e interesuara. Ky proces i miratimit të këtyre akteve përfundon në fillim të muajit nëntor. Ligji i ri për herë të parë pozicionon qartë palët në fushën e administrit të të drejtave, ku autori do të ketë mundësi përfundimtare nëpërmjet skemave të reja që janë parashikuar. Një tjetër ga-

ranci që buron nga ky ligj është rregullimi i marrëdhënieve të përfaqësimit agjenci - autor duke siguruar transparencë e llogaridhënie nga agjencitë për krijuesit dhe institucionet publike. Ky ligj tashmë mbron autorin përballë veprimeve arbitrare të shkelësve dhe i jep mundësinë të shpërblehet për punën e tij krijuese.

NJOFTIM ANKANDI

Studio Përmbartimore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e Dytë për pasurinë "Apartment" me nr. Pasurie 8/483+2-3.Vol. 22, Fq. 213, Z.K 8120 , e ndodhur në Rrugën "5 Maji", hyrja 2, shk.2, ap.3, Tiranë në pronësi të Artur Danaj.

Cmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 30.794.4 (tridhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katër) Euro.

Ankandi i Dytë zhvillohet më datë 28.10.2016, ora 16:00 në ambientet e Studios Përmbartimore "SHKRELA",

Adresa: Rruga: "George W.Bush", pranë Tatim Paguesve të Medhenj, Kati I, Tiranë

web: www.shkrelabelloffice.com

Gjosha: Greqia asnjëherë pengesë për Shqipërinë

Ministrja e Integrimit: "Kanabisi, as në Bruksel nuk janë indiferentë ndaj kësaj situatë"

ESIONA KONOMI
TIRANË

Agravimi i çështjes çame si një tension mes Tiranës dhe Athinës nuk pritet të përkthehet në një qëndrim bllokues të Greqisë për rekomandimin që pritet të japë Komisioni Evropian në 9 nëntor në Bruksel për Shqipërinë. Ministrja e Integrimit, Klajda Gjosha, tha në një intervistë për Shqiptarja.com se shteti helen ka mbështetur gjithmonë vendin tonë dhe pritet të ndryshojë qëndrimin. Ministrja e Integrimit shprehet me miratimin konsensual të reformës, nuk ka më kthim mbrapa. Ajo nuk pranoi të komentojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të marrë ditën e djeshme, por tha se Shqipëria ka plotësuar të gjitha kushtet. Sa i takon situatës së kanabisit në vend, Ministrja e Integrimit tha se "as në Bruksel nuk janë indiferentë ndaj kësaj situatë".

Znj. Ministre, fillimi i nëntorit do të jetë i rëndësishëm për procesin tonë të integrimit. Shqipëria kësaj radhe me kartën e reformës në drejtësi, është këmbëngulëse më shumë se asnjëherë tjetër për hapjen e negociatave. Çfarë prisni ju si ministre e linjës nga ky progres raport?

Raporti i nëntorit do të jetë shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, pasi siç ju e përmendni, ne kemi pasur një arritje historike për vendin. Reforma në drejtësi jo vetëm është një gur themeli për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë, i rikthen besimin qytetarëve tek sistemi i drejtësisë, por ka qenë dhe kusht i pa negociueshëm që Shqipëria të ecë përpara me procesin e integrimit. Me miratimin konsensual të kësaj reforme, ne plotësuam këtë kusht dhe kemi kërkuar një rekomandim pozitiv nga Komisioni Evropian. Unë e kam thënë edhe me herët. Procesi i integrimit është një proces i bazuar mbi meritën. Shqipëria nuk mund të jetë pjesë e BE-së, pa plotësuar kushtet dhe standardet e kërkuara, por nga ana tjetër besoj fort se përpejket tona reale duhet të vlerësohen po realisht nga vendet anëtare. Shqiptarët treguan se kanë vullnetin të bëjnë një reformë kaq madhore sa ajo në drejtësi, mendoj se ka ardhur moment që Komisioni Evropian të mbajë gjithashtu premtimin që u ka bërë shqiptarëve. E theksoj këtë, pasi në vetë kushtet në të cilat ndodhet Europa sot, ky do të ishte një sinjal i qartë që vendet anëtare janë gati të afrojnë çdo shtet aspirant që i përmbahet parimeve të tij, për një demokraci më të kon-

soliduar dhe për një shtet të së drejtës sa më të fortë. Reforma në drejtësi i mundëson të gjitha këto. Ne duam ta implementojmë këtë reformë përmes kapitujve 23 dhe 24 të cilët lidhen ngushtësisht me shtetin e së drejtës, marrja e një rekomandimi pozitiv në 9 nëntor do t'i hapte rrugën çeljes së negociatave dhe përmes tyre Shqipëria do të hyjë në një fazë të re dhe me konkrete me vetë BE-në, në funksion të procesit të integrimit. Ne shpresojmë që raporti të jetë pozitiv dhe të ndezë këtë dritë jeshile për Shqipërinë, pas hapave përpara të merituar.

Teksa më reformën në drejtësi kemi bërë progres të dukshëm, çfarë shihni ju si prioritet me të cilin nuk është aq sa duhet dhe mund të rrezikojmë?

Puna jonë ka qenë e fokusuar në plotësimin e 5 prioritetëve dhe siç e dini, lufta kundër korrupsionit, a p o

reformimi i sistemit gjyqësor, kanë qenë të lidhura ngushtësisht me reformën në drejtësi. Sigurisht që janë bërë hapa përpara, por mund të them se pas kësaj reforme rezultate më të dukshme dhe të matshme për këto prioritet do të jenë të pashmangshme. Prandaj ne insistojmë në një rekomandim pozitiv, në mënyrë që edhe zbatimi i reformës të jetë më i monitoruar.

Gjykata Kushtetuese ka pezulluar një ndër ligjet më themelore të reformës në drejtësi: vettingun. Si mendoni, a mund të ndikojë ky vendim i gjykatës në rekomandimin e nëntorit? A rrezikojmë prej tij?

Ne jetojmë në një vend demokratik, dhe vendimet që marrin gjykatat nuk mund të komentohen. Ajo që mund t'ju them, është se gjykata e ka pezulluar këtë ligj, dhe tani i takon Komisionit të Venecias të shprehet mbi ligjin e vettingut. Ne jemi të vendosur që pasi ky komision të shprehet, të vazhdojmë me implementimin e reformës në drejtësi.

A keni marrë sinjale shqetësuese nga Brukseli për situatën e kanabisit në Shqipëri?

Situata e krijuar me kanabisin është një sfidë shumë e madhe dhe mendoj që duhet të jetë paletë një prioritet i qeverisë shqiptare për të luftuar këtë fenomen. Nuk është e mjaftueshme vetëm puna që bën policia për të kapur dhe asgjësuar të gjithë rrënjët e kanabisit të mbjellë në Shqipëri, por ajo çka është shumë e rëndësishme është që të evidentojmë personat përgjegjës për këtë çështje. Sigurisht që as në Bruksel nuk janë indiferentë ndaj kësaj situatë.

Së fundmi, mes Shqipërisë dhe Greqisë është tendosur debati për çështjen çame. Kjo është një çështje e fqinjësisë së mirë. A mund ta përdorë influencën e saj Athina në këtë rast për të penguar hapjen e negociatave?

Greqia ka qenë dhe mbetet një mbështetëse



Eduard Kukan dhe Knut Fleckenstein

→ ÇËSHTJA ÇAME

Greqia ka qenë dhe mbetet një mbështetëse e fortë e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nuk besoj se Greqia do të ndryshojë këtë qëndrim të saj.

→ VETINGU

Ajo që mund t'ju them, është se gjykata e ka pezulluar këtë ligj, dhe tani i takon Komisionit të Venecias të shprehet mbi ligjin e vettingut. Ne jemi të vendosur që pasi ky komision të shprehet, të vazhdojmë me implementimin e reformës në drejtësi.

e fortë e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nuk besoj se Greqia do të ndryshojë këtë qëndrim të saj. Besoj gjithashtu se çdo problematikë e krijuar mund të gjejë një zgjidhje konstruktive dhe bashkëpunuese mes vendeve tona.

Ju keni zhvilluar një sërë takimesh me eurodeputetë. Çfarë qëndrimesh ju kanë përcjellë për progresin e Shqipërisë? Si është klima evropiane për vendet pretendente pas Brexitit?

Mund t'ju them me bindje të plotë se pas reformës në drejtësi, përgëzimet në të gjitha takimet që kam zhvilluar kanë qenë maksimale. Klima për Shqipërinë është pozitive, ashtu sikurse ka një vëmendje të madhe për atë çka do të bëhet më tej me reformën, rezultatet e pritshme, zbatimin e saj. Në lidhje me politikën e zgjerimit, mund t'ju them se Europa sot nuk është në momentin e saj më të mirë, zërat euro-skeptikë janë prezent brenda saj. Por nga ana tjetër, ne kemi edhe një frymë të re e cila ka nisur me procesin e Berlinit në 2014. Është mbështetja reale që po i jepet vendeve të Ballkanit perëndimor, për të përshpejtuar procesin e integrimit, përmes projekteve të përbashkëta infrastrukturore, të energjisë apo rinisë. Mendoj se është përgjigja më e mirë që mund t'ju jepet sot të gjithë zërave dyshues se e ardhmja e vendeve tona është vetëm brenda BE-së. Jam e bindur se kjo na shërben ne, por i shërben gjithashtu vetë Europës.

Nëse progresi raportoi do të rekomandojë hapjen e negociatave, cila është procedura për zyrtarizimin e këtij qëndrimi?

Në dhjetor do të jenë vendet anëtare që do të marrin një vendim mbi bazën e këtij rekomandimi, nëse do Shqipëria do t'i hapë apo jo negociatat. Nëse ky vendim është pozitiv, më tej kalohet në procedurën e zyrtarizimit të këtij procesi, që është një procedurë më teknike.

Kanabisi
Nuk është e mjaftueshme vetëm puna që bën policia për të asgjësuar të gjithë kanabisin e mbjellë. Shumë e rëndësishme është që të evidentojmë personat përgjegjës. Sigurisht që as në Bruksel nuk janë indiferentë ndaj kësaj situatë.

DENIS MINGA
TIRANË

Deputeti i Partisë Socialiste, Alfred Peza, njëherësh edhe nënkryetar i Komisionit të Medias, i ftuar në emisionin "45 minuta" të Denis Mingës, në Report Tv, ka folur për aktualitetin në vend, duke komentuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Vetëgungun, dhunën online dhe zgjedhjet e ardhshme. Peza u shpreh se priste që Kushtetuesja të pezullonte Vetëgungun sepse ky vendim, sipas tij, është një aleancë frike mes gjyqtarëve dhe PD në kurriz të shqiptarëve dhe reformës në drejtësi. Peza tha se shpresonte që Komisioni i Vencias t'i japë një përgjigje të shpejtë kësaj kërkesë dhe se po punohet edhe nga mazhoranca për këtë gjë. "Reforma në drejtësi mund të frenohet por nuk mund të nalet. E prisja. Sapo mora vesh lajmin thjesht m'u kujtua filmi dhe libri "Djali vishet me Prada", por sot "Djali vishet me toga të zeza" është versioni shqiptar i këtij vendimi. Është aleancë e atyre që kanë frikë në kurriz të të gjithë qytetarëve shqiptarë. Është një film i parë edhe më parë", tha Peza. Deputeti shtoi se më këtë vendim, Kushtetuesja i ka shpallur luftë SHBA. "Vendimi është shprehje e frikës dhe panikut në të cilin ndodhet një pjesë e gjyqësorit shqiptar. Kjo gjykatë është niveli më i epërm që duhet të ishte teorikisht gardiani i ligjit

Pezullimi i Vetëgungut, Alfred Peza: Aleancë e atyre që kanë frikë

"Duhet kuadër ligjor për median online, po shqyrtojmë nismën e Bregut"

→ MEDIAT ONLINE

"Sa i përket nismës së Bregut pati heshtje dhe më pas ka kaluar në shqyrtim. Jemi në fazën kur sapo ka ardhur në komision. Jam relator i çështjes nga ana e mazhorancës, jemi duke studiuar dhe do fillojmë që ta shqyrtojmë".

themelor të shtetit. Mesa duket e keqja ka shkuar shumë thellë. Në një farë mënyre me këtë vendim Gjykata Kushtetuese i ka shpallur luftë SHBA dhe BE. Kjo sepse ambasadori amerikan ka pasur deklaratë të fortë ndaj PD duke lënë të nënkuptohet se kush është pro dhe

kundër reformës. PD dhe anëtarët e kushtetueses u bënë një dhe rrëzuan vullnetin e pjesës dërrmuese të parlamentit dhe ndërkombëtarëve", pohoi Peza.

DHUNA ONLINE

Sa i përket dhunës online, Peza është shprehur se Komisioni i Ligjeve ka depozituar në Komision e Medias iniciativën e Majlinda Bregut për këtë çështje e cila do të shqyrtohet dhe më pas do të mbahet qëndrim. "Të gjithë jemi objekte dhe subjekte të komenteve sidomos kur je personazh publik. Kushdo mundet të vendosë një maskë online dhe të të prishë humorin apo të bëjë fyerje e shpifje. Sa i përket nismës së Bregut pati heshtje dhe më pas ka kaluar në shqyrtim. Në momentin që komi-

sioni i ligjeve kërkoi ndihmën edhe të organeve ndërkombëtare për këto problematika gjatë diskutimit me kolegët është parë e udhës që të mos shikohet thjesht si një çështje e veçuar ligjore por edhe si një çështje që lidhet me median dhe lirinë e saj. Jemi në fazën kur sapo ka ardhur në komision. Jam relator i çështjes nga ana e mazhorancës, jemi duke studiuar dhe do fillojmë që ta shqyrtojmë", pohoi Peza.

ZGJEDHJET

Në lidhje me zgjedhjet e ardhshme Peza është shprehur se Partia Socialiste është një makinë që qëndron gjithmonë në lëvizje dhe takimet e kryeministrit dhe figurave të tjera të partisë me qytetarët në të gjithë Shqipërinë e tregojnë këtë. "Shqipëria është një vend që duket



Alfred Peza

→ KUSHTETUESJA

"Vendimi është shprehje e frikës dhe panikut në të cilin ndodhet një pjesë e gjyqësorit shqiptar. Kjo gjykatë është niveli më i epërm që duhet të ishte teorikisht gardiani i ligjit themelor të shtetit".

sikur ka moto të jetës: "Nga luftërat vijmë në luftë shkojmë", apo "Nga zgjedhjet vijmë, në zgjedhje shkojmë". Gjithmonë diskutohet për zgjedhje. PS ka përshtatur organizimin e partisë sipas reformës territoriale. Është një makinë që është gjithmonë në lëvizje", tha Peza.

NJOFTIMI I ANKANDIT



1. **Autoriteti shites:** Albpetrol sha Patos, Rruga Fier - Patos km 7

2. **Data e zhvillimit të ankandit:** 31/10/2016

3. **Lloji i Procedurës standarde të ankandit:** Procedure e hapur

4. **Objekti i Shitjes:** Shitje naftë brut, sasia 200,000 ton

5. **Afati i evadimit:** 365 dite nga data e nënshkrimit të kontrates

6. **Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje naftës brut, sasia 200,000 ton, ne pikat e levrimit CTF Marinez (Bankers), Stacioni Kucove, Stacioni Usoje, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrez, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht, Stacioni Visoke.

7. VLERA FILLESTARE:

Ne kushtet FOB

Çmimi minimal fillestar per njesi eshte:
72.17 % e Çmimit Brent + K

Ne pikat e levrimit:

Çmimi minimal fillestar per njesi eshte:
72.17 % e Çmimit Brent - 3.79 USD/bbl + K

- 72.17 eshte koeficienti i cili perfaqeson karakteristikat mesatare fiziko-kimike te naftes per sasine prej 200 000 ton (pesha specifike, aciditeti i naftes, % e squfurit).

- Brent eshte çmimi ne \$/bbl i Brent(Dtd) i Platts.

Ne rastin e pageses ne cash, per llogaritjen do te merret referenca e Brent ne daten e kryerjes se pageses ne llogarin e Albpetrol sha.

Ne rast te pageses me Letër Credit (LC) per llogaritjen do te merret referenca e Brent i Platts edhe i publikuar ne Buletinin e Prokurimeve

Publike ne daten e protokollimit te L.C ne protokollin e Albpetrol sha Patos per llogari te Albpetrol sha Patos.

- 3.79 USD/bbl kosto mesatare totale transport, magazinim.

- K- eshte vlere \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal te shitjes te perlogaritur nga formula (K>0).

8. Vendndodhja e naftes brut: Albpetrol sha Patos

Ne pikat e levrimit CTF Marinez (Bankers), Stacioni Kucove, Stacioni Usoje, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrez, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht, Stacioni Visoke.

9. Vendi i zhvillimit të ankandit: Ministria e Energjise dhe Industrise, Sheshi Skenderbej, Tirane, salla e mbledhjeve kati I-re.

10. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: ne zyren e protokollit te Ministrise se Energjise dhe Industrise, datë 31/10/2016, ora 11:00

11. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites me paraqitjen e nje kerkese me shkrim ose ne faqen zyrtare te "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe ne faqen e Ministrise se Energjise dhe Industrise www.energija.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po ☐ Jo ☐ x

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos / Zyra në Tiranë Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë

T +3553813662

F +35534704415

W www.albpetrol.al

"Mbetjet", mazhoranca ndryshime në ligj, negociata

Ndryshimi, do vendosen kuota për importin e mbetjeve

Deputetët e Partisë Socialiste kanë reflektuar disa ndryshime në ligjin për importin e mbetjeve për riciklim në Shqipëri, pas kthimit të ligjit për rishqyrtim në Kuvend nga ana e Presidentit të Republikës, kontestimit nga një pjesë e shoqërisë civile dhe kërkesës së Lëvizjes Socialiste për Integrim për ekspertizë nga Bashkimi Evropian. Deputeti Taulant Balla dhe njëri prej iniciatorëve të ligjit, Eduard Shalsi, deklaruan dje se ligjit të miratuar i janë bërë disa ndryshime, ndërsa vijnë me intensitet konsultime për ndryshime të tjera. Ndryshimi kryesor ka të bëjë me vendosjen e kuotave për importin e mbetjeve. Megjithatë, gjatë takimi me ambientalistët nuk është arritur asnjë dakordësi. "Tashmë



SHALSI

Kemi folur për vendosjen e kuotave, mes asaj çka do të importohet dhe asaj që do të përpunohet në Shqipëri. Po shohim me shumë vëmendje heqjen e ngarkesave fiskale për industrinë e riciklimit. Jemi të hapur për diskutimin. Gjithashtu po shohim edhe heqjen e ngarkesave fiskale për ricikluesit. Duam të incentivojmë grumbullimin e mbetjeve në vend", tha Shalsi.

NË FOTO:

Eduard Shalsi, Taulant Balla dhe Besnik Bare në takime me përfaqësues të AKIP

me këtë propozim kemi një diskutim si asnjëherë më parë për plehrat ose mbetjet në Shqipëri. Është arritur një fitore që ka të bëjë me

sensibilizimin, që menaxhimi i mbetjeve është një moment madhor që duhet parë si një sfidë që nuk mund të fitohet nga politika por nga gjithë

shoqëria. Jemi dhe kemi qenë të hapur për çdo lloj iniciative që do t'i shërbejë menaxhimit të mbetjeve, duke filluar nga mbetjet në Shqipëri. Kemi

folur për vendosjen e kuotave, mes asaj çka do të importohet dhe asaj që do të përpunohet në Shqipëri. Po shohim me shumë vëmendje heqjen e ngarkesave fiskale për industrinë e riciklimit. Jemi të hapur për diskutimin. Gjithashtu po shohim edhe heqjen e ngarkesave fiskale për ricikluesit. Duam të incentivojmë grumbullimin e mbetjeve në vend", tha Shalsi.

DEPUTETI BALLA

Deputeti Taulant Balla pohoi se ligji për afron legjislacionin shqiptar me atë të BE. "Kemi realizuar një ligj që për afron legjislacionin shqiptar me atë të BE-së. Do vazhdojmë procesin e dëgjësive që në momentin e duhur të merret në shqyrtim dekreti i presidentit dhe të votohet në Kuvendin e Shqipërisë. Kemi bërë disa ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor për fuqizimin e industrisë së riciklimit. Zgjidhim një hall 25-vjeçar për trajtimin e mbetjeve urbane në Shqipëri. Ka takse për ndotjen në Shqipëri. Do të vazhdojmë ta bëjmë këtë proces dëgjësash dhe konsultimesh", tha Balla.

AKIP NUK LËSHON PE

Brisida Gjilkondi, aktiviste e AKIP-it, tha se nuk do të ketë asnjë tërheqje nga pozicioni. "Ne nuk lëvizim nga pozicioni jonë, as ata nga pozicioni i tyre. Për ne është e rëndësishme që importi i plehrave të mos kalojë. Kërkojmë të miratohet dekreti i Presidentit, të miratohet një moratorium për importin e plehrave derisa qytetarët të shprehin me referendum, sepse ky vendim nuk i takon më asnjë qeverie, as kësaj që po ikën dhe as asaj që do të vijë, i takon qytetarëve shqiptarë ta vendosin me referendum popullor", tha ajo.



Basha me përfaqësues të AKIP

BASHA

Shqipëria është e mbuluar nga plehrat, qytetet tona, fshatrat tona, lumenjtë tanë janë mbuluar me plehra.

TAKIMI ME AKIP

Lulzim Basha: Moratorium për mbetjet deri në referendum

Kreu i PD: Të miratohet dekreti i Bujar Nishanit

Kryetari i opozitës, Lulzim Basha, ka zhvilluar dje një takim me përfaqësues të AKIP, ku ka kërkuar miratimin e dekretit të Presidentit për rrëzimin e ligjit të mbetjeve. Po ashtu, Basha ka propozuar miratimin e një moratoriumi për ndalimin e importit të mbetjeve, deri në mbajtjen e një referendumi. "Na bashkon ky ligj për të cilin qëndrimi jonë është i qartë. Të miratohet dekreti i Presidentit, të miratohet një moratorium për importin e plehrave deri sa qytetarët të shprehin me referendum. Sepse ky vendim nuk i takon më asnjë qeverie, as kësaj që po ikën dhe as asaj që do të vijë, i takon qytetarëve shqiptarë ta vendosin me referendum popullor. Dhe deri në atë moment të miratohet dekreti i Presidentit Nishani

dhe bashkë me të një moratorium për importin e plehrave. Dhe bashkërisht jam i bindur se në të njëjtën frymë do të punojmë në një aleancë të madhe kundër drogës, për dekriminalizimin, për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe për të rikthyer dinjitetin e shqiptarëve duke iu rikthyer besimin dhe të drejtën për të zgjedhur me votë qeverisjen që dëshirojnë", tha Basha. Kryetari i opozitës, Lulzim Basha ka artikuluar akuza në adresë të qeverisë. "Sot kjo është ka ekspozuar në mënyrë të plotë pafytyrësinë e qeverisjes, pafytyrësinë kriminale të Edi Ramës, sepse jo vetëm anuloi këtë ligj në 2013-ën, por në 2014-ën me një Vendim të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të anulimit të ligjit, krijoi një detyrim ligjor që deri në fund të vitit 2016, pra për dy muaj, të gjitha bashkitë e vendit të përfundonin me mbështetje qeveritare procesin e diferencimit të mbetjeve. Me anë të së cilës; e para do të arrihej një pastrim më i mirë i Shqipërisë nga plehrat, nga mbetjet; dhe e dyta do të arrihej një objektivi sekundar, ai i përpunimit, riciklimit të tyre nga industria e riciklimit në Shqipëri", pohoi Basha. Sipas tij, sot, Edi Rama ka

dështuar të zbatojë VKM-në që vetë miratoi. "Shqipëria është e mbuluar nga plehrat, qytetet tona, fshatrat tona, lumenjtë tanë janë mbuluar me plehra. Plehrat digjen në mënyrë kriminale, ndotin ambientin tonë. Të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë tregojnë se të sëmuret e rrugëve respiratore dhe sëmundjet e rënda, siç është kanceri në mushkëri janë dhjetëfishuar si rezultat i përkeqësimit të ndjeshëm të cilësisë së ajrit, në veçanti në tre vitet e fundit në Tiranë, siç e tregoi studimi i para disa ditëve", tha Lulzim Basha.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

TË KETË ARSIM TË LARTË


TË KETË PËRVOJË PUNE

TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN: marketing@shqiptarja.com

FJALIMI

Deputetja Mesila Doda ka ngritur Çështjen Çame në Gjenevë



Deputetja Mesila Doda ka ngritur Çështjen Çame në Unionin Ndërparlamentar që mbledhet në Gjenevë të Zvicrës. Para deputetëve nga e gjithë bota, ajo ka rrëfyer historinë e Çamërisë, duke e treguar si histori të familjes së saj. "Është një rast i jashtëzakonshëm për mua të jem sot e pranishme në këtë seancë, në të cilën flitet për thelbin e qytetërit tonë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe pasojat katastrofike që sjell pashmangshmërisht mosrespektimi i tyre. Historia e njerëzimit njeh shembuj të panumërta të cënimit të tyre, shembuj të afërt e të largët, por unë dua të sjell sot para jush një histori personale, që vjen nga një tragjedi genocidi e përjetuar nga rreth 30.000 shqiptarë të Çamërisë, krahinës që sot përfshihet në Greqinë e Veriut. Këta njerëz jetuan, u torturuan dhe në fund u depërtuan duke humbur çdo të drejtë njerëzore për shpirt dhe jetën në spastrimin etnik që bandat pronaziste të kohës bëjnë me to", tha Doda. Më tej ligjëvendësja shqiptare ka vënë në dukje se sa shumë artikuj të dy konventave të OKB-së të nënshkruara edhe nga shteti grek janë shkelur me të dyja këmbët në rastin e tragjedisë çame. "Do e nis me dy Konventa të OKB; Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimeve të Genocidit 1948 dhe Konventën për Krimet e luftës 1948. Shqipëria dhe Greqia janë vende anëtare dhe kanë firmosur në të dyja këto Konventa. Në të përcaktohen qartë detyrimet e shteteve anëtare për të zbardhur dhe dënuar çdo formë të krimeve të luftës dhe ato të spastrimit të një etnie, race apo grupimi tjetër. Në të përcaktohen edhe mosmarrëveshtjet, sepse janë vepra me pasojë të rënda për njerëzimin, ndaj kjo çështje nuk është tabu, duhet të respektojmë konventat ndërkombëtare", pohoi Doda.

Beogradi dhe Athina "trazojnë" Komisionin e Politikës së Jashtme

Aldo Bumçi: Serbia po kryen një spastrim
etnik të heshtur! Dade: Jeni i pasaktë!



Komisioni për Politikën e Jashtme

ESIONA EKONOMI TIRANË

Komisioni për Politikën e Jashtme zhvilloi seancë dëgjimore me Zëvendësministër të Punëve të Jashtme, Halil Hyseni, për sa i përket praktikave konsullore dhe shërbimeve që u ofrohen nga shteti shqiptar bashkatdhetarëve tanë. Zëvendësministri i Punëve të Jashtme tha se shërbimi konsullor në Greqi është përmirësuar, duke krijuar aplikimin konsullor online. Hyseni sqaroi se është diskutuar me palën greke mundësia për mënjanimin e ngërçit të toponimeve, dhe pajisur qytetarët tanë me dokumentacion të vlefshëm për zyrat dhe procedurat e tyre atje. "Është diskutuar me palën greke heqja e rezervës të vendosur nga shteti grek mbi aderimin e vendit tonë në Konventën e Hagës, për vulën apostile. Shtetit grek i është kërkuar zgjidhja për njohjen e dokumenteve të gjendjes civile të lëshuar nga konsullatat tona, në rastet, kur njëri nga bashkëshortët nuk ka qëndrim të hershëm në Greqi", tha Hyseni.

GREQIA

Gjithashtu, Hyseni sqaroi se MPJ ka ofruar asistencë për 200 mijë qytetarë shqiptar jashtë vendit dhe se lista e shërbimeve konsullore përfshin një gamë të gjerë shërbimesh, si legalizim dokumentesh, vizat për të huajt, dokumentet noteri, etj. Gjatë diskutimeve, demokrati Aldo Bumçi ngriti shqetësimin për rritjen e numrit të azilkërkuesve shqiptarë në Gjermani, ndërsa kryetarja e Komisionit Arta Dade, tha se ka një rënie drastike të shqiptarëve që i drejtohen Gjermanisë, dhe se tashmë po zhvillohet një proces për rikthimin e atyre që kanë emigruar. "Numrat janë dyfishuar. Kemi disa vite që jemi dëshmitarë të azil kërkuesve në Gjermani. Numrat janë dyfishuar brenda vitit," - u shpreh Bumçi. Por Kryetarja e Komisionit, Arta Dade e kundërshtoi këtë fakt, duke theksuar se problemi i azilkërkuesve është zgjidhur dhe shifrat e përmendura nga deputeti Bumçi, janë të pasakta. "Problemi i azilkërk-

Financimet

Përqindjet e kontributeve të palëve kontraktuese tek buxheti i ZRBR-së:

Shqipëria	17.3%	173 000 Euro
Bosnja dhe Hercegovina	15.4%	
Kosova	10.2%	
Maqedonia	13.8%	
Mali i Zi	4.4%	
Serbia	38.9%	

uesve në Gjermani ka një vit që është zgjidhur, nëpërmjet kanalizimit të kontratave të punëdhënësve në Gjermani. Ne duhet të biem dakord që kjo çështje është zgjidhur. Jeni i pasaktë në shifra," - deklaroi Dade.

SERBIA

Po dje, komisioni miratoi dhe projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor", e cila

synon të inkurajojë më tej bashkëpunimin e të rinjve, mirëkuptimin reciprok dhe shkëmbimin e përvojave, me qëllim forcimin e stabilitetit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe progresin në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja mbi ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, ndjek objektivat e përcaktuara si pjesë e "Procesit të Berlinit" dhe bazuar në "Deklaratën e përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Ballkanin Perëndimor". Sipas Dades, hapja e kësaj zyre do t'i japë një impuls të ri marrëdhënieve dhe shkëmbimit përmes të rinjve, duke i dhënë një risi bashkëpunimit rajonal. Nënkrjetari i komisionit Aldo Bumçi, ngriti pikëpyetjet për misionin që do ketë zyra rajonale për Bashkëpunim Rinor në Tiranë, e cila u miratua

ARTA DADE

"Problemi i azilkërkuesve në Gjermani ka një vit që është zgjidhur, nëpërmjet kanalizimit të kontratave të punëdhënësve në Gjermani. Ne duhet të biem dakord që kjo çështje është zgjidhur. Jeni i pasaktë në shifra,"

në mbledhjen e djeshme. Ai deklaroi se nuk mund të flitet për frymë bashkëpunimi me Serbinë, kur ky shtet nuk njeht ende diplomat shqiptarë. "Këtu u tha që kjo zyra rajonale është një nismë e Shqipërisë dhe Serbisë, në vitin 2014. Është zhvilluar vizita e Zotit Rama në Serbi, ku u tha se është nënshkruar marrëveshja e njohjes së

diplomave të qytetarëve shqiptarë, me shtetësi serbe që kanë studiuar në Shqipëri. Çka po sjell një spastrim etnik të heshtur. Kur nuk është realizuar kjo çështje për çfarë fryme po flasim? Si ka mundësi që nuk u njihen diplomat të rinjve shqiptarë nga Lugina e Preshevs nga Bujanovci dhe trojet e tjera? Për çfarë shërbën kjo zyrë rajonale që do të ngrihet?" - theksoi Bumçi. Kryetarja e Komisionit, Arta Dade theksoi se marrëveshja e nënshkruar nga dy kryeministrit do kohë për të hyrë në fuqi. "Unë mendoj që kur bien dakord dy kryeministra ka një kohë të caktuar derisa të hyjnë në fuqi marrëveshja," - nënvizoi ajo. Dade deklaroi se ngritja e zyrës rajonale do t'i japë një impuls të ri marrëdhënieve dhe shkëmbimit përmes të rinjve, duke i dhënë një risi bashkëpunimit rajonal.

AKTIVITETI / EUROPA UPËRBALL ME VALËN MË TË MADHE TË EMIGRACIONIT

"Të ikësh apo të rrih", dilema e Ballkanit në Gjermani

Përse njerëzit largohen nga vendet e Ballkanit? Është kjo pyetje e ngritur javën që kaloi në një aktivitet të zhvilluar në Ulm të Gjermanisë ku të ftuar nga Ballkanit Perëndimor ndanë këndvështrimet e tyre me qytetarët gjermanë lidhur me arsyet ekonomike, sociale dhe politike që kanë detyruar qytetarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë të ikën masivisht drejt Europës. "Të ikësh apo të rrih" titullohej paneli që mbledhi në qytetin e Ulmit gazetarë dhe analistë politikë i organizuar nga Qendra Federale për Edukim Qytetar. Në 2015ën, Europa u përball me valën më të madhe të emigracionit që pas Luftës së Dytë Botërore. Vetëm në Gjermani, erdhën mbi 1 milionë refugjatë duke sfiduar autoritetet gjermane dhe vetë qytetarët të vënë përballë një situatë të paprecedentë. Por që pas mbylljes së të ashtuquajturës "rruga ballkanike" numri i refugjatëve është reduktuar ndjeshëm. E ndërsa numri më i madh i refugjatëve ishin nga vendet në konflikt si Siria dhe Afganistani, një pjesë e tyre vinin nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Aktiviteti u zhvillua në dy panele të ndara ku në të parin ishin të ftuar gazetarja e Report TV, Erjona Rusi dhe

Besa Shahini, analiste politike në Iniciativën e Stabilitetit European (ESI), nën moderimin e gazetarit dhe shkrimtarit gjerman Uwe Rada dhe gazetarit serb Andrej Ivanji, korrespondent i disa mediaeve gjermane në Beograd. Thuajse të gjithë pjesëmarrësit argumentuan se ndër arsyet kryesore që njerëzit largohen nga vendet e Ballkanit, pavarësisht specifikave që ka secili prej tyre, është mbi të gjitha mungesa e perspektivës, që ka të bëjë jo vetëm me zhvillimin ekonomik por edhe

me situatën politike dhe nivelin e lartë të korrupsionit. Ndërsa në mbledhjen e dytë, në panel ishin të ftuar Ana Petrusheva, gazetare në Maqedoni dhe bashkëthemeluese e Rrjetit Ballkanik për Raportim Investigativ dhe Milan Aleksić, studiues i shkencave politike në Serbi. Aleksić parashtrroi situatën e vështirë ekonomike me të cilën po përballlet aktualisht Serbia pavarësisht faktit se vendi ka nisur që në janar të 2014ës negociatat për anëtarësim me BE-në që kanë sjellë



Aktiviteti në Ulm të Gjermanisë

mjaft ndryshime pozitive. Ndërsa Petrusheva vuri theksin tek kaosi politik që ka përfshirë Maqedoninë ndërsa Greqia kërcënon se do të bojkotojë negociatat për shkak të çështjes së pazgjidhur të emrit.

Në eventin Dita e Kujtesës

Historia e dhimbshme shqiptare përlot Vlahutin

Një histori e dhimbshme shqiptare në eventin Dita e Kujtesës ka përlotur Ambasadorën e BE në Shqipëri, Romana Vlahutin. Duke sjellë në vëmendje një tragjedi të familjes së saj, Vlahutin, theksoi se e rëndësishme është mbyllja përfundimtare e plagëve të regjimit të shkuar komunist. Ajo shtoi se pagja e njerëzve që kanë vuajtur torturat dhe familejeve të cilët kanë humbur njerëzit e afërt, është e vonuar dhe ka pasojë për të ardhmen. "E di se ç'do të thotë kjo, nga rasti im. Gjyshja ime kishte 4 djem. Një prej tyre vdiq në luftë, larg nga shtëpia. Ishte 17 vjeç. Kur ajo mësoi se ai ishte vrarë, dhe asnjë nuk mund t'i thoshte se ku saktësisht, ajo filloi të ecte, dhe asgjë, absolutisht

asgjë nuk do ta ndalonte atë të kërkonte fëmijën e saj. Ajo eci për ditë me radhë, thjeshtë eci dhe kërkoi kudo dhe në fund e gjeti. E sollë në shtëpi, e varrosi dhe nga gjithë dhimbja e saj, gjeti pak paqe. Pa këtë përmbyllje, do të ishte pothuajse e pamundur për të gjetur forcë dhe për të vazhduar përpara. Njerëzit meritojnë dhe kanë nevojë për përmbyllje, por shqetësimi që kanë nevojë për përmbyllje gjithashtu", tha ajo. E pranishme në event, zëvendësministria Nora Malaj, tha se rëndësi merr lënda e historisë në të gjitha nivelet e shkollimit. Aktiviteti, do të vazhdojë përgjatë gjithë javës dhe balafaqimi i së shkuarës do të kulmojë më 28 tetor me aktivitetin për hapjen e dosjeve të sigurimit.

Spahiu i LSI-së këmbëngul: Duhet kryeministër i yni

Kandidati për kryetar: S'mund të mbajmë faturën e dështimeve të partive të tjera

ESIONA KONOMI
TIRANE

Përparim Spahiu përforcon mendimin e tij se LSI duhet të ketë një kryeministër të saj, dhe nuk ka pse të marrë kostot e vendimarrjeve të partive të tjera në qeverisje. Këto qëndrime në kuadër të fushatës brenda LSI-së nuk po i kundërshtojnë askush nga kupola drejtuese e partisë së tij. Koha kur PS dhe LSI do të duhet të rishikojnë marrëveshjen e tyre politike para zgjedhjeve parlamentare është gjithnjë e më e afërt, dhe retorika e Përparim Spahiut, me shumë sesa qëndrime personale, duket një zëdhënie e LSI-së, e mbushur me mesazhe për aleatët. Në kuadër të fushatës për zgjedhjet e 6 nëntorit, kandidatët për kryetarë të LSI-së, Shezai Rrokaj dhe Përparim Spahiu si edhe Nënkyetari i LSI-së, Endrit Braimllari, zhvilluan një takim me strukturat e kësaj force politike në Pogradec. Kandidati për

→ SPAHIU:

"LSI të ketë një rol udhëheqës në politikën shqiptare. Ne nuk duhet të paguajmë më faturën e dështimeve dhe të mëkateve të partive të tjera që kanë nevojë për votat tona, që marrin timon e Shqipërisë dhe bëjnë eksperimente me drejtimin e saj".

kryetari i LSI-së, Përparim Spahiu, tha se LSI është e vetmja forcë politike që rritet çdo ditë dhe që në të ardhmen duhet të ketë një rol parësor dhe një udhëheqës në politikën shqiptare. "Ilir Meta ka bërë një marrëveshje për të bashkëqeverisur në koalicion me Partinë Socialiste, një marrëveshje e ndershme politike për ta çuar Shqipërinë disa hapa përpara. Mirëpo për të çuar përpara, në analizën time, por jo vetëm në analizën dhe gjykimin

tim, disa gjëra janë bërë me ngërce ose nuk janë bërë fare. Unë mendoj se këto zhgënjime të shqiptarëve, në anëtarët e LSI duhet t'i shohim me sy kritik dhe t'i minimizojmë që tani. Ka ardhur koha që LSI, e cila është e vetmja forcë politike që rritet çdo ditë, të ketë një rol parësor dhe një udhëheqës në politikën shqiptare dhe në shoqërinë shqiptare. Për mua, por jo vetëm, LSI duhet të jetë e para që nuk duhet të prodhojnë kryeministër që nuk kanë taserën e partisë sonë dhe që na vendosin përpara faktit të kryer në shumë vendimarrje të rëndësishme. Sepse ne nuk duhet të paguajmë më faturën e dështimeve dhe të mëkateve të partive të tjera që kanë nevojë për votat tona, që marrin timon e Shqipërisë dhe bëjnë eksperimente me drejtimin e saj", deklaroi Spahiu. Kandidati tjetër për kryetar, Shezai Rrokaj, tha se platforma e tij i shërben shëndoshjes së LSI-së dhe se kjo është një garë mendimesh, platformash, që do të nxjerrin një fitues dhe asnjë humbës. "Unë mendoj se platforma

→ RROKAJ:

"Unë mendoj se platforma ime i shërben shëndoshjes së LSI. Sepse unë nuk mendoj se kjo është një garë rivale, kjo është një garë mendimesh, platformash, që në fund të ditës do të nxjerrin një fitues dhe asnjë humbës. Fituesi do të jetë LSI".

ime i shërben shëndoshjes së LSI. Sepse unë nuk mendoj se kjo është një garë rivale, kjo është një garë mendimesh, platformash, që në fund të ditës do të nxjerrin një fitues dhe asnjë humbës. Fituesi do të jetë LSI", - u shpreh Rrokaj. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim, Endrit Braimllari tha se gara e 6 nëntorit e forcon Lëvizjen Socialiste për Integritet dhe e bën më gjithëpërfshirëse e më të hapur për të rinjtë e të rejtat. "Është një garë e cila forcon Lëvizjen

Socialiste për Integritet, është një garë e cila e bën LSI më të fortë, më të bashkuar, e vazhdon rrugën e hapjes së LSI, por mbi të gjitha është një garë që do të sjellë një ristrukturim total të gjithë strukturave të LSI. Ajo çka është më e rëndësishme për LSI ka të bëjë gjithëpërfshirjen. LSI është e hapur për të gjithë ata që kontribuuan ndër vite, por nga ana tjetër LSI është e mirëpritur për të gjithë ata të rinj dhe të reja që duan të japin kontribut dhe të vazhdojnë rrugën e suksesit, rrugën e pandalshme në shërbim të qytetarëve shqiptarë. Pogradeci ka nevojë për politikanë të cilët kontribuojnë në parlament për rritjen e investimeve, që llobojnë në parlament për zhvillimin e turizmit, por mbi të gjitha Pogradeci ka nevojë për një klasë politike të përgjegjshme, për një klasë politike e cila siguron një të ardhme të suksesshme për të gjithë këta të rinj dhe të reja", deklaroi Nënkyetari i LSI-së, Braimllari. Gjatë takimit në Pogradec u shpërndanë gjithashtu edhe 300 karta të reja anëtarësi.



Shezai Rrokaj dhe Përparim Spahiu, në Pogradec

REFORMA ZGJEDHORE

Ambasadori Christoph Graf: Vendi juaj ka potenciale të fuqishme për zhvillim

Zvicra: Shqipëria po zbaton reforma të rëndësishme

Shqipëria po kalon një moment të rëndësishëm përsa i përket zbatimit të një sërë reformash, mes tyre ajo territoriale dhe thellimi i asaj për decentralizimin e pushtetit". Deklarata erdhi nga ambasadori i Zvicrës në vendin tonë, Christoph Graf gjatë tryezës së organizuar me mbështetjen e ambasadës Zvicerane në bashkinë e Malësisë së Madhe, ku mermin pjesë kryebashkiakët e veriut. "Shqipëria është në zbatim të një sërë reformash të rëndësishme dhe ky është një moment për të përfutur dhe për t'i kthyer ato në potenciale të fuqishme për zhvillimin e vendit, siç është rasti konkret i reformës

NË FOTO:
Takimi në
bashkinë e
Malësisë së
Madhe



territoriale-administrative. Si rezultat i ristrukturimit të territorit, ju si kryetar bashkish, do t'i duhet të menaxhoni teritorë më të gjera dhe më komplekse, por në të njëjtën kohë me angazhimin e partnerëve, bizneseve dhe aktorëve të ndryshëm të komunitetit, mundësitë për t'i kthyer këto në potenciale zhvillimi janë edhe më të

larta", tha ambasadori zviceran. E pranishme në këtë takim ishte edhe ministrja e zhvillimit urban, Eglantina Gjermeni theksoi se zona e veriut ofron potenciale zhvillimi të jashtëzakonshme dhe ministria do të jetë gjithmonë në mbështetje të bashkive të kësaj zone. "Hartimi i planëve vendore është një proces historik. Flasin për plane që

nuk u bënë për më shumë se 20 vite, e që tani janë dokumente strategjike që do të na shërbejnë për zhvillimin e zonave ku jetojmë. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) është një instrument shumë i rëndësishëm, i cili do të përcaktojë vizionin dhe rregullat, për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve urbane dhe rurale. Në këtë këndvështrim, do kërkoja maksimalisht që nga bashkia dhe ekspertët e përfshirë nëpërmjet donatorit, si dhe me monitorimin nga AKPT, të ndërtohet një proces shumë gjithëpërfshirës konsultimesh dhe marrje mendimesh nga të gjithë aktorët dhe grupet e interesit", deklaroi Ministrja e Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni. Ministrja ka shprehur bindjen se brenda këtij viti bashkitë kryesore në vend do të kenë të miratuar planin vendore. Pas mbështetjes së 3 bashkive, edhe dy të tjera do të kenë fatin të marrin të njëjtën përkrahje nga ambasada Zvicerane për planin vendor, Klosi dhe Vau Dejës.



Noka-Ramës:

"Cinik, flet për mirëqenie në zonën më të varfër"

Nga Kukësi, deputeti demokrat i zonës, Flamur Noka, ka reaguar menjëherë pas deklarave të kryeministrit Edi Rama gjatë takimit me fermerë në Shishtavec. Noka thotë se "është cinizmi ekstrem i Ramës që flet për paga e mirëqenie në zonën më të varfër". "Akuzon që nuk ka rrugë ndërkohë Rama shkoi në Shishtavec nga rruga e Kombit. Është cinizmi ekstrem i Ramës që flet për paga e për mirëqenie në zonën më të varfër. Dua të pyes Edi Ramën se kush i boshatisi këto zona nga banorët. Banorët e Kukësit nuk jetojnë në plantacione hashashi, prandaj janë të varfër", shprehet Noka. Noka e bëri këtë deklaratë teksa inspektonte fillimin e punimeve të rikonstruksionit të një rruge në Laqjen e re të qytetit të Kukësit, investim i Bashkisë Kukëse.

Rama: PD është e dëshpëruar, hedh helm ndaj shqiptarëve

Ironi Blushit: Të mos e njihnim do ta dëgjonim, por e njohim

Kryeministri Edi Rama i është përgjigjur nga Shishtavec i Kukësit, akuzave të opozitës, për mungesën e investimeve në tre vitet e kësaj qeverisje. Gjatë një takimi me fermerët, Rama u shpreh se ata që akuzojnë sot, kanë qenë në pushtet për 25 vite dhe kanë bërë më shumë dëme sesa punë. Kreu i qeverisë theksoi se PD po tenton të helmojë shqiptarët me dëshpërimin e saj. "Flasin në emër të popullit për varfërinë, por nuk e dinë se çfarë është varfëria. 20 e ca vite e kishin mundësinë dhe nuk e bënë. Kanë kaluar nga karrigia në karrige dhe nga partia në parti, për punët e tyre në emër të popullit. Këta s'kemi çfarë t'i dëgjojmë, sepse i kemi parë. Bënë më shumë dëm sesa punë, janë bërë edhe punë, por janë bërë më shumë dëme. Me të gjitha ato para që janë harxhuar, kanë dalë nga xhepi i shqiptarëve nga taksat për 25 vite me punët që janë në oborrin e shtëpisë tonë, llogaria s'del. Po të shikosh sa para janë harxhuar për ujësjellësa nga '91, sot do të kishim shtruar tubat e ujit për Shqipërinë, Kosovën dhe Tetovën. Ky është realiteti. E këta dinë vetëm të helmojnë me dëshpërimin e tyre dhe të marrin për hunde sa më shumë njerëz që dëshpërimi i pengon që të shohin shpresë dhe që lodhja ua ka soursur durimin", u shpreh Rama. Kreu i qeverisë theksoi se reformat janë fokusi i punës së qeverisë, për aq kohë sa ai do të jetë Kryeministër. "S'kam ndërmend të rri gjatë në atë zyrë, por unë kam ardhur këtu që deri kur të rri kushti të jetë të bëjmë reforma, pastaj 4 vjet,

DEKLARATAT

Blushit

Rama thumboi edhe Ben Blushin, duke shfrytëzuar një debat mes fermerëve se kush do të marrë fjalën i pari. "Ti që flet kaq shumë do me bë parti të re, mos të njëfishin do thoshin hajt ta ngjojmë, por s'të dëgjon njeri se të njoftin", ndërhyri Rama



Edi Rama me fermerët në Shishtavec, Kukës

Reformat

"Reformat i bëmë, se nuk do thonë më hajt tani lidhuni nëpër tela, kush ta kapi ta kapi, do vijë njeri pas do i vërshtëllëjë e do thotë bjere Pasqyrën, Vitrinën, Kristalin, hajde diplomat, u vu gardhi. Ne kemi vënë vetëm themelin, nuk kemi bërë shtëpinë" tha Rama. Nga Kukësi, një zonë e cila tradicionalisht voton të

le të thonë nuk e mbajmë dot vëlla, se do fillojmë me kamomil me rrena, por reformat i bëmë, se nuk do thonë më hajt tani lidhuni nëpër tela, kush ta kapi ta kapi, do vijë njeri pas do i vërshtëllëjë e do thotë bjere Pasqyrën, Vitrinën, Kristalin, hajde diplomat, u vu gardhi. Ne kemi vënë vetëm themelin, nuk kemi bërë shtëpinë" tha Rama. Nga Kukësi, një zonë e cila tradicionalisht voton të

djathtë, Rama tha përmes batutave se nuk pret tifozllëk për të, por ai la të kuptohet se pavarësisht kësaj, do t'i fitojë sërisht zgjedhjet edhe në 2017-ën. "Unë me Partizanin jam, këtu s'kam shpresë të ketë tifozllëk për mua, por Partizani do fitojë, kjo kuptohet", tha Rama, duke shtuar se, "nuk pretendoj të them se shikoni sa shumë gjëra kemi bërë për Kukësin, është e vërtetë nuk

kemi bërë aq shumë". Kryeministri thumboi edhe Ben Blushin, duke shfrytëzuar një debat mes fermerëve se kush do të marrë fjalën i pari. "Ti që flet kaq shumë do me bë parti të re, mos të njëfishin do thoshin hajt ta ngjojmë, por s'të dëgjon njeri se të njoftin", ndërhyri Rama. Duke iu rikthyer edhe njëherë shqetësimeve të banorëve, Rama theksoi se konfliktet

për pronat kanë sjellë 8 mijë vrasje e plagosje në 25 vite. "8 mijë vrasje e plagosje në Shqipëri, për pronën, kjo është një masakër. Për faj të shtetit, për faj të këtyre që bëjnë teori, që na bëjnë me gisht ne për plagët që hapen vetë. Duan ta marrin sërisht për budalla këtë popull, a thua se nuk ishin në pushtet për 25 vjet. Pse nuk i bënë këto?", tha Rama.

Pas vizitës në Kukës

Kryeministri Rama vizitë në Prishtinë, takim me Thaçin

Pas vizitës në Kukës, kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një vizitë edhe në Kosovë, ku është takuar me presidentin e vendit, Hashim Thaçi. Ai është parë të hyjë rreth mesditës në një prej hoteleve më të njohura të Prishtinës, ku paralelisht po mbahej një takim i rëndësishëm i liderëve të politikës kosovare mbi kryeqeshitjen e tyre: demarkacionin. Burimet bëjnë me dije për një takim miqësor me Thaçin dhe zyrtarë të tjerë, dhe takimet kanë qenë informale. Kjo është vizita e parë dhe pse informale që kryhet pas debateve Prishtinë-Tiranë që pas vizitës së fundit të Ramës në Beograd.

Urgjenca mjekësore në Kukës dyfishon kapacitetet

Shtohen tre ambulanca, stacionim dhe në Has e Tropojë

Shërbimi i urgjencës mjekësore në Kukës, do të funksionojë për qytetarët në mënyrë krejt të re, i riorganizuar nga themelet për të qenë më shpejt dhe më pranë nevojave të tyre. Duke nisur nga java e ardhshme 109 mijë banorët e këtij qarku do të shërbehen njëherësh me 6 autoambulanca nga 3 deri më tani, të cilat janë të monitoruara nëpërmjet një sistemi elektronik gjurmimi satelitor (GPS) në çdo moment, duke siguruar gjithashtu, një mbulim më cilësor dhe më efikas të territorit. Për herë të parë, autoambulanca do të jenë të stacionuara përveç qytetit të Kukësit, edhe në qendra të tjera të Qarkut si Hasi e Tropoja, në mënyrë që një autoambulancë t'u shërbejë 18 mijë banorëve, nga raporti i me 36 mijë që ishte më parë. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar

Projekti i qeverisë

Rilindja urbane, Kukësi me qendër të re

Sipas qeverisë, qendra dhe disa lagje të Kukësit ofrojnë sot për qytetarët një pamje krejt të ndryshme, falë ndërhyrjeve intensive urbane që kanë pësuar. Shëtitoret dhe parku, dhe rrugë dytësore janë rikonceptuar tërësisht, sipas projektit rikualifikues, investim prej afro 2 milionë dollarë, i përfunduar tashmë, financim i programit të qeverisë për Rilindjen Urbane. "Qendra shpaloet si një hapësirë interaktive, me elemente arkitektonikë dhe muzealë të traditave kuksiane. Ndërsa sipërfaqet e gjelbëruara, sinjalistika, trotualet e asfaltuara dhe ndriçimi, pjesë e këtij investimi janë dëshmitë e transformimit urban të saj. Kryeministri Rama, i cili ndodhej në Kukës, i shoqëruar nga Ministri Beqaj dhe deputetë të zonës, vizitoi qendrën që me ndryshimet e realizuara sjell më shumë energji pozitive për komunitetin dhe më shumë tërheqje për turistë dhe vizitorë", -thuhet në njoftimin e qeverisë.


nga Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj, si dhe Drejtori i Qendrës Kombëtare Mjekësore Skënder Brataj ishte dje në Kukës, ku u prezantua vendndodhja e re e autoambulancave, të cilat nga mëngjesi në darkë, në shtatë ditë të javës do të jenë aty, për të kursyer të paktën kohën e vajtjes për thirrjet e urgjencës. Gjithashtu, në funksion të këtij riorganizimi do të ketë më shumë autoambulanca njëherësh pasi shtohet personeli i shërbimit. Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj, u shpreh se qëllimi është të krijohet një urgjencë mjekësore e cila do të jetë efi-kase në shërbimin e saj ndaj qytetarëve. Ai tha se mbetet ende për të bërë në drejtim të përmirësimit të pajisjeve mjekësore brenda autoambulancave, si dhe përmirësimin e aftësive të personelit mjekësor që shërben aty. "Ne praktikisht



Edi Rama dhe Ilir Beqaj në urgjencën e Kukësit

këtu arrimë nga tre ambulanca në dispozicion për të gjithë qarkun të kalojmë në 6, të zbrisim 1 në 18 mijë." - u shpreh ai. Drejtori i qendrës kombëtare mjekësore Skënder Brataj bëri një prezantim të detajuar të situatës së nevojave mjekësore në Kukës dhe të mënyrës së si do të funksionojë shërbimi i ri i urgjencës. Ai bëri të ditur se Kukësi është qarku i 7, i cili do të funksionojë me riorganizimin e ri, ndërsa mbeten edhe 5 qarqe të tjera për të plotësuar 12 të tilla, në të gjithë vendin. Ai informoi ndër të tjera se në shërbim të urgjencës është vënë edhe një helikopter, si dhe në raste të aksidenteve, apo kur ka

fluks të madh të turistëve, një nga autoambulanca mund të spotohet në Morinë. Kryeministri Rama u shpreh se reforma në shërbimin e urgjencës në shkallë vendi do t'i japë përfundimisht zgjidhjen një problemi kronik të trashëguar prej vitesh, të mospërgjigjes në kohë dhe me shpejtësi në terren të nevojave mjekësore. Kryeministri theksoi se rikonceptimi i mënyrës se si sistemi është i organizuar në funksion të shpërndarjes së autoambulancave, jep një pamje tërësisht të re, duke ndryshuar rrënjësisht raportet mes numrit të autoambulancave dhe numrit të qytetarëve në nevojë për shërbim urgjencë.



Besmir Vathi

NË FLAGRANCË

Në magazinën dy katërshe, në katin e dytë janë kapur në flagrancë duke punuar shtetasit Ferit Sula, Ali Kuçi, Ersialdo Nikolla, Besmir Vathi.



Fatos Sulaj

■ THASËT ME DROGË

Në një nga dhomat në katin e dytë të banesës u gjetën, u fiksuan dhe më pas u morën në cilësinë e provës materiale 142 thasë me drogë të thatë.



Magazina e grogës në fshatin Dervin

Dy mijë rreshta me tela për tharjen e hashashit

Trafikikimi i 30 kg në Malin e Zi dhe 142 thasë me drogë

ELTON QYNO
TIRANË


Në sasi prej 30 kile drogë, ishte përgatitur në magazinën e zbuluar me hashash në fshatin Dervin, për tu transportuar drejt Malit të Zi. Kjo sasi ishte bërë gati nga të arrestuarit Gjovalin Gjojeja dhe Marius Leka. Lënda narkotike nuk ka mundur të dalë nga magazina dhe të niset drejt Malit të Zi, për shkak se policia dhe prokuroria kanë pikasur aktivitetin e këtij grupi duke ndërhyrë për asgjësimin e saj. Pas arrestimit të 12 personave, financuesit dhe puntorët janë përgjyur në mënyrë ambientale në ambientet e policisë së Durrësit, duke përfutur biseda që tregojnë të gjithë aktivitetin e këtij grupi kriminal. Ndërkohë që gjatë operacionit policia dhe prokuroria kanë zbuluar disa dhoma ku ishin ndërtuar 2 mijë rreshta me tel për të tharë sasinë e drogës. Ndërkohë në banesën e shtetasit Kujtim Rexhepi allias Valentin Smykalova, janë sekuestruar 142 thasë të mbushur plot me drogë të thatë, e gatshme për tu paketuar dhe shitur.

ZBULIMI I MAGAZINËS

Ka rezultuar se në datën 18 tetor 2016, rreth orës 20:00 nga ana e efektivëve të Drejtorisë së Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimit e Rënda Tiranë, pasi kanë qenë të planëzuar me shërbim në aksin rrugor të Fushë Krujë, kryesisht në fshatin Dervin, në krahun e majtë të drejtimit të lëvizjes rreth 100 metra sapo kalon lokal restorant "Vllaznia", u konstatua një magazinë dykatëshe me ngjyrë të bardhë, me dritare e cati. Nga raportet e vëzhgimit ka rezultuar se automjetet "Audi Q7", me ngjyrë të zezë, me targë AA 066 LD, kamioncinë ngjyrë blu dhe jeshile, tip "IVECO", me targë AA 216 DD, furgon i bardhë me targë AA057GL, "Wolkswagen Sharon" me ngjyrë gri, me targë AA 762 DH, si dhe dy automjete tjera janë parë duke hyrë dhe

150 POLICË AKSION

Shkodër asgjësohen 6555 bimë kanabis



Policia e Shtetit vijon operacionet antidrogë në të gjithë vendin për goditjen e kultivimit dhe trafikimit të drogës, ndërsa ka identifikuar dhe asgjësuar në Shkodër 6555 bimë në proces tharje. Në operacionin e zhvilluar kanë marrë pjesë 150 policë, në bashkëpunim me FNSH Shkodër dhe Tiranë, ndërsa u zbuluan 3 sara në tokë pa pronar të përshtatura për grumbullimin dhe tharjen e 6555 bimëve narkotike. Lënda narkotike u asgjësua me anë të djegjes, ndërsa vazhdojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të implikuar në këtë veprimtari kriminale të fushës së kultivimit, prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Lidhur me këtë çështje materialet hetimore i kaluan prokurorisë së rrethit gjyqësor Shkodër.

dalë disa herë nga magazina. Më pas është bërë ndërhyrja dhe është bërë e mundur kapja në flagrancë duke bërë djegjen e bimëve narkotike shtetasit Erjon Vathi, ndërsa një person tjetër është larguar dhe më pas është identifikuar si shtetas Ervin Gjojeja, drejtuesi i mjeteve të drogës, me targë AA 216 DD. Në vazhdim është ndërhyrë dhe në magazinën dy katëshe ku në katin



Kujtim Rexhepi

e dytë janë kapur në flagrancë duke punuar shtetasit Ferit Sula, Ali Kuçi, Ersialdo Nikolla, Besmir Vathi.

PËRGJIMI AMBIENTAL NË POLICI

Për një hetim sa më të plotë dhe objektiv të kësaj veprë penale, pas konkludimit të bërë me prokurorinë është bërë dhe përgjimi ambiental midis personave të dyshuar si autorë të kësaj veprë penale. Përgjimi është bërë në ambientet e drejtorisë vendore të Policisë Durrës, nga ku kanë rezultuar biseda me interes për faktet objekt hetimi dhe autorët e veprave penale. Në vazhdim të veprimeve të policisë në një lokal, pranë vendit ku është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike, është bërë dhe kapja në flagrancë e shtetasve Kujtim Rexhepi allias Valentin Smykalova, Gazmir Gjojeja, Nilson Gega, Gjovalin Gjojeja dhe Aurel Gjojeja. Është bërë pyetja e shtetasve të lartpërmendur ku personat që janë kapur brenda në magazinë, puntorët e kanë pranuar faktin që janë marrë me qethjen dhe rregullimin e lëndës narkotike, ndërsa personat e tjerë që janë kapur në lokal nuk japin shpjegime në lidhje me lëndën narkotike që është gjetur në magazinë dhe në banesën e shtetasit Kujtim Rexhepi.

GRUPI KRIMINAL

Sa më sipër, duke marrë në

TË ARRESTUAR

- Gentian Permaku
- Artan Sallaku
- Kejvi Tuga
- Edmir Diva
- Osman Morina
- Gjellosh Vuksani
- L.M në kërkim

konsideratë faktin e gjetjes dhe të sekuestrimit të një sasi të madhe lënde të dyshuar narkotike Cannabis sativa, faktin që është gjetur në formë bimore të rritur, të butë dhe të thatë, faktin që për sjelljen në këtë fazë të kësaj lënde është dashur një punë disa mujore dhe e shumë personave, duke siguruar si fillim farën, mbjelljen, kultivimin, e më pas prerjen, tharjen dhe përgatitjen për shitjen e saj brenda dhe jashtë vendit, krijohen dyshime të arsyeshme dhe të mbështetura në prova se shtetasit Kujtim Rexhepi (Valentin Smykalova), Gazmir Gjojeja, Nilson Gega, Gjovalin Gjojeja, Aurel Gjojeja, Ferit Sula, Ali Kuçi, Ersialdo Nikolla, Besmir Vathi, Erjon Vathi, Erald Bardhoku në bashkëpunim midis tyre në formën e grupit të strukturuar kriminal kanë kultivuar lëndë narkotike si dhe kanë prodhuar e mbajtur lëndë narkotike të

dyshuar të llojit cannabis sativa.

30 KILE DREJT MALIT TË ZI

Gjatë hetimeve janë krijuar dyshime të bazuara në prova se shtetasit e arrestuar Gjovalin Gjojeja dhe Marius Leka në bashkëpunim midis tyre kanë tentuar të trafikojnë për në Malin e Zi, një sasi prej 30 kg lëndë narkotike të llojit cannabis sativa, e cila ka qenë e vendosur në pako. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, bërë në kompleksin ku janë kapur në flagrancë punëtorë duke përpunuar lëndën narkotike te një kontenier i modifikuar si shtëpi e mobiluar me orendi shtëpiake të vjetra në një distancë rreth 10 dhjetë metra nga kompleksi, në një nga dhomat, në një divan janë gjetur në pjesën e sipërme të divanit, një armë zjarri brezi model TT kalibër 7,62 mm, me krehër me 7 fishekë, armë zjarri brezi model "Makarov Sheskin".

2 MIJË RRESHTA ME TELA PËR TË THARË DROGËN

Nga këqyrja e vendit, banesës së pabanuar që sipas deklaratimeve të marra shtetasit Valentin Smykalova, posedohej nga ana e tij, banesë që ndodhej ngjitur me banesën ku banonte ky shtetas, ka rezultuar se banesa ishte me dy kate, e ndarë me dy porta hyrjeje dhe nga këqyrja e bërë në këto dhoma, në pesë prej tyre u gjetën bimë narkotike në proces tharjeje, si

dhe dy armë automatike model 56, kalibër 7,62 mm me një krehër me 30 tridhjetë fishekë, si dhe një armë pushkë model 56, kalibër 7,62 mm të cilat u morën në cilësinë e provës materiale për ekzaminim të mëtejshëm. Në pesë dhomat gjendeshin tela ku ishin varur degëza bimësh për t'u tharë, ku nga numërimi i këtyre rezultoi të ishin 2000 dy mijë rreshta, si dhe arka me mbetje të bimëve të dyshuara si narkotike të llojit Cannabis sativa, të gjitha këto u asgjësuan me anën e djegjes.

142 THASË PLOT ME DROGË TË THATË

Në një nga dhomat në katin e dytë të banesës u gjetën, u fiksuan dhe më pas u morën në cilësinë e provës materiale 142 thasë të mbushur me masë bimore në gjendje të thatë, ku një pjesë e këtyre thasëve ishte prej linoje dhe një pjesë e vogël prej plastmase me ngjyrë të zezë. Të gjithë këta thasë u morën në cilësinë e provës materiale me qëllim ekzaminimin e lëndës dhe peshimin e saj. Peshimi i bërë lëndës narkotike e cila u gjet te kompleksi dhe te banesa e shtetasit Valentin Smykalova, e cila u fut dhe u mbyll në qese të provave të përkrahura në procesverbalin e peshimit ka rezultuar të ketë një peshë totale prej 1.190 kg e 685 gramë lëndë narkotike e llojit Cannabis sativa. Nga këqyrja e bërë automjetit "Wolkswagen Sharon" me targë AA762DH është gjetur dhe sekuestruar një sasi masë bimore e dyshuar si lëndë narkotike e llojit Cannabis sativa, e cila pasi u fiksua, sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Tharje droge në pesë nivele mbi skela ndërtimi

Kapen 1.4 ton kanabis në Mamurras. Arrestohen gjashtë persona, financuesi në kërkim. Nën hetim dhe dy elektrikistë

ELTON QYNO
TIRANE

Vetëm 5 ditë nga zbulimi i magazinës me drogë në fshatin Derven të Fushë-Krujës ku u zbuluan 1.3 ton kanabis stativa, një tjetër magazinë me drogë është zbuluar afër kësaj zone. Gjatë ditës së djeshme efektive të policisë në bashkëpunim edhe me Prokurorinë e Krimeve të Rënda janë futur në një magazinë të mbushur me drogë, e cila shërbente edhe për krastitjen, grirjen dhe më pas tharjen e lëndës narkotike. Sipas policisë në total, janë sekuestruar 1450 kilogram kanabis, ndërkohë në pranga janë vënë disa shtetas, Gentian Pepmarku 20 vjeç, Artan Sallaku 35 vjeç, Kejvin Tuga 18 vjeç, Edmir Diva 28 vjeç, Osman Morina 67 vjeç dhe Gjelo Shukani 53 vjeç, të gjithë banues në Mamurras. Lënda narkotike ishte vendosur në skela ndërtimi, dhe autorët kishin krijuar 5 nivele tharje mbi to. Për tharjen sa më shpejt të saj, grupi kriminal me ndihmën e dy elektrikistëve të OSHEE kishte mundësuar lidhje të paligjshme të energjisë, me të cilën kishin lidhur fërnella ngrohëse. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se magazina ku ishte grumbulluar droga, i përkiste shtetasit Gjelo Shukani. Magazina gjatë rregimit



Doga e tharë në Mamurras

komunist ka shërbyer për grumbullimin e grurit të kooperativave bujqësore, por që tashmë personat e sipërcituar e kishin kthyer atë në një hambar për grumbullimin e sasive

të ndryshme të drogës dhe përpunimit të saj.

PRANGA PUNËTORËVE FINANCIUESI NË KËRKIM

Pjesa më e madhe e perso-

nave të arrestuar kanë qënë puntorët, të cilët kryenin procesin e krehjes së rrënjëve të drogës, grigrjes dhe më pas tharjes së lëndës narkotike. Për tharjen, në depon e grumbullimit ishin ngritur skela ndërtimi dhe mbi to ishin krijuar 5 nivele, në të cilën kryhej tharja e lëndës narkotike. Kjo sasi prej 1.4 tonë drogë mendohet se i përket shtetasit me inicialet L.M., që tashmë është shpallur në kërkim nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Sipas hetimeve ky person është njeriu që ka financuar dhe ka organizuar këtë aktivitet kriminal.

DY ELEKTRICISTË

Gjatë aksionit u sekuestruan 1 pushkë, 1 granatë dore, 1 automatik, fishekë, ventilatorë për përpunim droge, dylbi, kamera vëzhgimi si dhe mjete të tjera elektronike në funksion të procesit të tharjes së bimëve narkotike. Po në lidhje me këtë ngjarje janë proceduar penalisht në gjendje të lirë edhe dy elektrikistë B.M. 51 vjeç, banues në Mamurras dhe Xh.D. 53 vjeç, banues në Mamurras pasi në magazinën e gjetur është konstatuar e instaluar energji elektrike dhe nga verifikimet ka rezultuar se ishte lidhje e paligjshme, ndërsa dy elektrikistët, sipas policisë nuk kanë bërë verifikimet e duhura.

PRONARI

Kjo sasi prej 1.4 tonë drogë mendohet se i përket shtetasit me inicialet L.M., që tashmë është shpallur në kërkim nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Sipas hetimeve ky person është njeriu që ka financuar dhe ka organizuar këtë aktivitet kriminal.

GRUMBULLIMI

Magazina gjatë rregimit komunist ka shërbyer për grumbullimin e grurit të kooperativave bujqësore, por që tashmë personat e sipërcituar e kishin kthyer atë në një hambar për grumbullimin e sasive të ndryshme të drogës dhe përpunimit të saj.

Hetimet DURRËS

Plot 19 kilogramë kokainë e pastër u zbulua në doganën italiane mes një ngarkese me pula të ngrira që udhëtonte me kontener nga Brazili. Pulat pritej të mbërrinin në Durrës por nuk dihet ende se kush do të ishte marrësi i tyre, në adresë të kujt do të importohet sasia e pulave të ngrira që udhëtonin nga Brazili me destinacion Shqipërinë Policia e Durrësit është vënë në lëvizje lidhur me ngarkesën prej 19 kg kokainë, që pritej të vinte në Durrës nga Amerika Latinë përmes kontenerëve të pulave. Sasia e drogës u kap në Itali, teksa autoritetet në vendin fqinj kanë bllokuar dokumentacionin e kompanisë që kishte porositur ngarkesën me pula në vendet latine. Blutë e qytetit Durrësit kanë kërkuar informacion nga homologët italianë për kompaninë që ka bërë porosinë.

Kokainë tek pulat, kush e priste në Durrës ngarkesën nga Brazili?

Policia në kërkim të biznesmenit që fshihet pas porosisë së drogës

Do të jenë hetimet ku hetuesit shqiptarë pas informacioneve që do të kenë marrë nga kolegët italianë pasi të kenë shqyrtuar dokumentacionet e kompanive shqiptare që importojnë pula frigoriferike nga Amerika Latine do të mund të përcaktojnë kompaninë që do të tërhiqte ngarkesën në Durrës. Droga e fshehur mes pulave të ngrira që udhëtonin nga paraanagua e Brazilit u zbulua dhe nga oficerët e komandës provinciale të "Guardia di Finanza"-s së Reggio Calabrias, në portin e Gioia Tauro. Sipas policisë itali-

ane, destinacioni përfundimtar do të ishte Porti i Durrësit. Nëse hidhej në treg, kokaina do të kapte vlerën e 4 milionë eurove.

PSE U FUT MES PULAVE

Sasia e pulave të ngrira në kontener udhëtonte nga Paranagua e Brazilit dhe bashke me to dhe 19 kg kokainë e ndarë në 17 pako që destinacion kishte Durrësin. Por ngarkesa u zbulua në doganat italiane. Mediat italiane i bëjnë ende jehonë lajmit të zbulimit të kokainës me adresë Shqipërinë duke nxjerrë detaje sesi e zbuluan drogën e fshehur

me atë mëshhtëri tek pulat e ngrira. Droga u zbulua dhe nga oficerët e komandës provinciale të "Guardia di Finanza"-s së Reggio Calabrias, së bashku me funksionarë të zyrës kundër mashtrimit tregtar të Agjencisë së Doganave të Gioia Tauros, në koordinim me Drejtorinë lokale të Antimafias. Fillimisht është verifikuar dokumentacioni që dispononte drejtuesi i automjetit, por agjentët dyshuan për rrugën që kishte zgjedhur për të mbërritur në portin e Gioia Tauros dhe më pas destinacioni përfundimtar do të ishte Porti i



Durrësit. Policia ra në gjurmë të këtij transporti pas dyshimeve të dokumenteve dhe kontrollit të ngarkesës. Më tej agjentët italianë përdorën pajisjet e skanerit të doganës dhe qentë e Guardia di Finanza. Skaneri ka rezultuar e suksesshme pasi shmang edhe kontrollin nga qentë antidrogë. Këta të fundit e kanë të pamundur të nuhasin lëndën narkotike nëse ajo është brenda kontenerëve me mish. Vetëm skanerët e përdorur në këtë rast arritën të evidentonin drogën dhe më pas menjëherë është kryer ar-

restimi i drejtuesit të kamionit. Droga e llojit kokainë e ndarë në 17 pako ishte fshehur pikërisht në brendësi të një konteneri që transportonte pula të ngrira që vinin nga Paranagua e Brazilit do transportohet në Durrës. Nëse hidhej në treg, kokaina kapte vlerën e 4 milionë eurove. Aktiviteti i "Guardia di Finanza"-s së Reggio Calabrias është pjesë e intensifikimit të kontroleve në lidhje me trafikun e drogës në rajonet kalabreze, teksa që prej fillimit të vitit kanë kapur thuhet 1.100 kg kokainë të pastër.

Dosja e pezulluar SHISH dhe policia harrojnë Isa Çopën

Pesë vjet nga vrasja mafioze e zv/drejtorit të SHISH në Durrës, asnjë person i identifikuar

ELTON QYNO
TIRANE

RAPORTIMI

Janë mbushur 5 vjet nga ekzekutimi mafioz i agjentit të Shërbimit Informativ Shtetëror Isa Çopës, vijon të qëndrojë e "mbërthyer" nga misteri, ndërkohë nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda nuk është arritur të zbardhet asnjë nga pistat e hetuara, që mund të kishte sjellë zbulimin e autorëve të këtij krimi. Burimet shtuan se

Si institucioni i SHISH dhe Policia e Shtetit kanë haruar tashmë dosjen e vrasjes së zyrtarit të tyre, duke mos bërë asnjë raportim në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

NJË PLUMB

Ekspertiza, ka evidentuar se Çopa ka marrë një plagë në kokë dhe se plumbi ka qënë i pistoletës së shërbimit. Plumbi ka qënë tejshekues, ndërkohë që ka dalë mbi kabinën e makinës.

deri në këtë kohë, policia por qoftë dhe SHISH nuk kanë sjellë asnjë informacion të ri për këtë çështje, që mund të shërbejë për riapjen e dosjes dhe vijimin e hetimeve në një pistë konkrete. Si institucioni i SHISH dhe Policia e Shtetit kanë haruar tashmë dosjen e vrasjes së zyrtarit të tyre, duke mos bërë asnjë raportim

në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

RAPORTI NGA MYNIHU

Një laborator me ekspertë të mjekësisë-Ligjore në Mynih të Gjermanisë, i caktuar nga prokuroria për kryerjen e analizave me qëllim përcaktimin nëse Isa Çopa ishte vetëvrasë apo vrasë, ka dalë në konkluzionin se agjenti i SHISH është ekzekutuar më parë dhe më pas është djegur brenda në makinën e tij, tip "Opel Corsa". Sipas raportit disa faqesh të përpiluar në gjuhën gjermane dhe që është përkthyer pranë Ministrisë së Drejtësisë e që tashmë ndodhet në duart e prokurorëve, zv/drejtori i SHISH-it në Durrës dhe shefi i kundërbulimit për të huajt, është vrarë dhe jo vetëvrasë. "Nga kryerja e analizave laboratorike në shtetin gjerman, është arritur në konkluzion se Isa Çopa është dhunuar fillimisht, është goditur disa herë në kokë me sende të forta, çka i kanë shkaktuar thyerje të kafkës dhe dëmtime të trurit. Më pas mendohet se në gjendje asfiksie është vendosur në sediljen e pasme të makinës së tij të llojit "Opel



Isa Çopën

Corsa". Makina nga brenda dhe jashtë është spërkatur me benzinë dhe më pas i është vënë flaka. Viktima edhe pse i goditur në kokë dhe me dëmtime të mëdha në kafkë, ka vazhduar të marrë frymë edhe në kohën që makina po digjej. Në mushkëritë e tij ekspertët kanë gjetur bluzë.

HETIMI

Për gjurmimin e çështjes përveç efektivëve të policisë së Durrësit janë angazhuar edhe kolegë të viktimës Çopa, të cilët nën drejtimin e dy prokurorëve të çështjes, janë përqendruar në dy pista hetimore: Atë për shkak të punës si zv/drejtor i SHISH-it dhe shefi i kundërbulimit dhe dyshimeve për hetimet operative që Çopa kishte nisur për disa të

huaj, investitorë në gjirin e Lulëz. Trupi i pajetë i oficerit të kundërbulimit në drejtorinë e SHISH-it në Durrës, u gjet mesnatën e 24 tetorit 2011, në rrugën pranë ish-repartit ushtarak të Currilave. Hetuesit zbuluan se makina e oficerit, tip "Opel Corsa", është spërkatur me benzinë dhe i është vënë flaka. Për pasojë, viktima ishte shkrumbuar tërësisht. Isa Çopës fillimisht i është prerë gjuha, më pas është goditur në kokë me sende të forta dhe kur ka qënë ende gjallë është vendosur në makinë, së cilës i kanë vënë flakën dhe e kanë djegur. Ekspertiza, ka evidentuar se Çopa ka marrë një plagë në kokë dhe se plumbi ka qënë i pistoletës së shërbimit. Plumbi ka qënë tejshekues, ndërkohë që ka dalë mbi kabinën e makinës.

DËNOHET GAPI

"Do u hedh në erë me eksploziv" terrorizohen punonjësit e bankës



53-vjeçari Qazim Gapi kërcënoi para një viti punonjësit e dy filialeve të një banke të nivelit të dytë në Tiranë se do t'i hidhte në erë, ndërsa gjykata e ka dënua me 18 muaj në shërbim prove. I akuzuari kërkoi nga punonjësit e dy filialeve nëse kishin kaluar para në llogarinë e tij nga ana e një kompani private, por llogaria nuk ishte kredituar duke sjellë edhe reagimin e ashpër të tij. 53-vjeçari ka ngritur këmbishën duke u treguar atyre një pako të mbështjellë, në dukje si eksploziv ndërsa është shprehur se do t'u hedh në erë duke i kërcënuar. Qazim Gapi u shpall fajtor për "kanosje për shkak të detyrës" dhe "prishje e qetësisë publike, por gjykata urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të dënimit 6 muaj për një afat 18 muaj me kusht që i pandehuri të mos kryej vepër tjetër penale.

BEQJA TREGON TAKIMET ME MIQTË E EMILJANO SHULLAZIT

"Atë pronë do e gëzojë Mili, hedhim në tokë më të mirin"

Biznesmeni Ylvi Beqja tashmë me statusin e dëshmitarit të mbrojtur të drejtësisë, ka rrëfyer para hetuesve edhe për momentet e kërcënimit të tij pas arrestimit të Emiljano Shullazit në prill të këtij viti. Ylvi Beqja me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë Arabe Saudi Brothers ka treguar se pas arrestimit të Shullazit është ndjerë i lehtësuar. Por kjo i ka zgjatur vetëm pak ditë, pasi ka konstatuar se ishte në vëzhgim thuasje 24 orë nga njerëzit e Shullazit. Në deklarime, ai ka thënë se çdo ditë konstatohe poshtë pallatit makina të ndryshme me personat që i kishte parë kur takohet me Shullazin, të cilët e vëzhgonin dhe ndiqnin nga lëvizte. Në mesin e këtyre

RËFIMI

Ata më thanë, "jo ore, atë pronë do ta gëzoj vetëm Mili, ta ka thënë edhe vet. Nëse ke ndonjë problem tjetër më tha e zgjidhim se ne hedhim në tokë edhe më të mirin" y takim, sipas Beqjas e ka bindur që të bashkëpunojë me drejtësinë, duke treguar me detaje kalvarin e proceseve gjyqësore, njohjen me Shullazin

personave që e vëzhgonin, Beqja ka thënë se ishte edhe nipi i Shullazit, i arrestuari i pak ditëve më parë Endri Zela dhe shoku i tij Endrit

Qyqja. Ai ka rrëfyer edhe një episode të bisedës mes tyre poshtë pallatit ku Beqja bantonte me familjen. Më mori në telefon Endrit Qyqja dhe kërkoi ta takoja. Unë i thash jam në shtëpi dhe më thanë të zbrisja të rrugica ngjitur e pallatit. Kur dola aty, erdhën me një benz të ri dhe më zunë rrugën. Brenda ishin Endrit Qyqja dhe Endri Zela. Dolën nga makina dhe më thanë që mos të flas poshtë e lartë. I kërkova ti thonë Emiljano Shullazit, që të më jap 700 mijë euro që të heq dorë nga pronat, ish-hotel Vollga, se më kanë bllokuar prokuroria. Ata më thanë, "jo ore, atë pronë do ta gëzoj vetëm Mili, ta ka thënë edhe vet. Nëse ke ndonjë problem tjetër më tha e zgjidhim se ne hedhim

në tokë edhe më të mirin". Ky takim, sipas Beqjas e ka bindur që të bashkëpunojë me drejtësinë, duke treguar me detaje kalvarin e proceseve gjyqësore, njohjen me Shullazin, gjatë të cilës ka paguar atij apo edhe kalimin e pronës nën kërcënimin e armës. Nga ana tjetër, për llogari të kësaj dosje, mësohet se prokuroria ka marrë dhe pyetur me cilësinë e dëshmitarëve dy noterë, të cilët kanë bërë veprime për llogari të Ylvi Beqjas dhe Emiljano Shullazit. Në një moment, një nga noterët ka dëshmuar se çdo takim me Shullazin detyrohej të mbyllte qepenin e zyrës pasi ai shoqërohej me rreth 15 persona. Dy ditë pas regjistrimit të pronës, ku Shullazi kishte



Ylvi Beqja

marr 30 për qind të pronës, noterja ka shpërgjuar se në 9 të darkës dy makina kishin shkuar te zyra, duke i marrë certifikatën e pronës së ish-hotel Vollgës. Për marrjen e saj, noterja ka shpërgjuar se ka njoftuar edhe Ylvi Beqjan,

i cili i kishte thënë se nuk kam çfarë të bëj. Për këto dhe veprime tjera kriminale, prokuroria po heton Emiljano Shullazin dhe të dyshuarit si pjesëtarët të "bandës" së tij, për akuzën "grupit të strukturuar kriminal".

Klima e biznesit, përmirësohet me 32 vende

Raporti i BB vlerëson pozitivisht. Shqipëria është pozicionuar në vendin e 58 nga 190 vende

Shqipëria është përmirësuar me 32 vende në raportin e Bankës Botërore 'Doing Business për 2017'. Shqipëria është pozicionuar në vendin e 58 nga 190 vende. Në raport theksohet përmirësimi në marrjen e lejeve të ndërtimit, sigurimi i energjisë, pagimi i taksave. Ministria e Ekonomisë, Milva Ekonomi e cilësoi si historike renditjen e Shqipërisë për këtë vit në raportin e publikuar. "Renditja dhe vlerësimi më i mirë që Shqipëria ka patur ndonjëherë, që nga viti 2003 kur ky raport u publikua për herë të parë nga Banka Botërore. Raporti

konfirmon rritjen cilësore të reformave të ndërmarrja nga Qeveria për lehtësitë e të bërit biznes, duke nënvizuar se distanca e Shqipërisë ndaj praktikave më të mira, në të bërit biznes ka patur një përmirësim të dukshëm, duke u rritur nga 61.3 pikë në raportin e vitit të kaluar në 68.9 pikë në raportin e sivjetshëm" tha ministria. I vetmi vendim i qeverisë shqiptare që ka pasur ndikim negativ në renditjen e Shqipërisë ka qenë ai për të skanuar në mënyrë të detyrueshme në dogana çdo mall që importohet ose eksportohet. Megjithatë sipas ministres, ky vendi që ndonjëherë mund

të ngadalësojë procedurat e eksport/importit është tejte i rëndësishëm në kushtet e debatit të sotëm për sigurinë e mallrave që importohen në vend, apo të debatit për importin e mbetjeve të riciklueshme.

MINISTRIA EKONOMI: RAPORTI HISTORIK

"Pak minuta me parë, Banka Botërore publikoi raportin e saj të përvitshëm "Të bërit biznes". Vendi ynë renditet i 58-tinga 190 shtete që Banka Botërore vlerësoi këtë vit. Ky është jo vetëm një përmirësim i dukshëm prej 32 vendesh në krahasim me vitin e kaluar, por është njëkohësisht ren-

ditja dhe vlerësimi më i mirë që Shqipëria ka patur ndonjëherë, që nga viti 2003 kur ky raport u publikua për herë të parë nga Banka Botërore. Gjithashtu raporti konfirmon rritjen cilësore të reformave të ndërmarrja nga Qeveria për lehtësitë e të bërit biznes, duke nënvizuar se distanca e Shqipërisë ndaj praktikave më të mira, në të bërit biznes ka patur një përmirësim të dukshëm, duke u rritur nga 61.3 pikë në raportin e vitit të kaluar në 68.9 pikë në raportin e sivjetshëm. Vlerësimi i Bankës Botërore ka një rëndësi të veçantë, jo vetëm sepse konfirmon që reformat e ndërmarrja nga qeveria



Milva Ekonomi

janë duke ecur në drejtimin e duhur, por çka është më e rëndësishme, sepse inkurajon investitorët e huaj për të ardhur në Shqipëri, pasi

vendi ynë është miqësor ndaj sipërmarrësve të huaj dhe të bërit biznes tek në VLEN", tha ndër të tjera ministria e Ekonomisë, Milva Ekonomi.

Familjet në nevojë, reduktim ose zerim kamatash abonentëve korrekt

Ministri i Damian Gjikhuri: Për paguesit e rregullt falje të tjera

Të paktën 35 mijë familjarë, mes të cilëve katërori në nevojë, do të përfitojnë falje të mëtejshme të kamatës nëse vazh-

dojnë të jenë të rregullt me pagesat e detyrimeve të prapambetura dhe faturën mujore, sipas aktmarrëveshjes që kanë me OSHEE-në. "Për të gjithë ata që kanë qenë të rregullt me këstet, ne po mendojmë të bëjmë një tjetër lëshim, për të gjithë juve", deklaroi ministri i Energjitikës, Damian Gjikhuri në një takim me abonentët. "Kategoritë në ndihmë ekonomike, invalidët, pensionistët do të ketë zerim të kamatës nëse kundërt një pagese simbolike", tha Adrian Çela, drejtor i OSHEE-së. Kjo vlerë simbolike është 20 lekë. Ndërsa

vlera që parashikohet të falet nga OSHEE llogaritet në 8 deri në 9 miliardë lekë. Kategoritë në nevojë, sipas aktmarrëveshjes, shlyejnë detyrimet e prapambetura me një kësht prej 1.200 lekë në muaj. Ndërsa për konsumatorët e tjerë familjarë, pagesa mujore për borxhin ndaj OSHEE është 2.800 lekë. Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjikhuri shoqëruar nga administratori i Operatorit të Shpërndarjes Adrian Çela ishin dhe në një prej Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit në Tiranë ku bashkëbisedoi me familjarë përfitues nga

skemat lehtësuese të shlyerjes së borxheve të prapambetura të energjisë. Për periudhën 2014-2016 rezultoi të jenë nënshkruar në total 424,405 aktmarrëveshje me abonentëve familjarë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Rreth 65 mijë prej tyre janë lidhur prej abonentëve me ndihmë ekonomike, pensionistë kryefamiljarë dhe me status të veçantë. Deri më tani, nga të gjitha aktmarrëveshjet për familjarë, kanë përfituar reduktim kamatash 225,312 abonentë në vlerën totale prej 4,6 miliard lekë.



Damian Gjikhuri

INFRASTRUKTURA

Veliaj: Investime në çdo lagje të Tiranës

Nis puna për rikualifikimin urban e një tjetër blloku banesash në kryeqytet. Bashkia e Tiranës po zbaton projektin e rikualifikimit urban të lagjes përgjatë rrugës "Vëllezërit Manastirliu", i cili parashikon ndërhyrjen në një sipërfaqe prej rreth 3,5 ha, ku përfshihen punime edhe në 8 segmente rrugore. Nisja e punimeve u inspektua nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili theksoi se, edhe në këtë lagje, investimi i bashkisë synon të sjellë standarde të barabarta jetese si në çdo zonë tjetër të kryeqytetit, ku është ndërhyrë deri më tani. "Më vjen mirë që po ndërhyjmë në Rr. "Vëllezërit Manastirliu", që njihet ndryshe si blloku mbas rrugës së ambasadeve. Ka ardhur koha ta bëjmë këtë lagje si 'jashtë shtetit', me infrastrukturë të denjë, duke

qenë se ndodhet shumë pranë selive diplomatike të Tiranës", tha Veliaj. Ai falenderoi banorët që janë treguar të gatshëm të ngushtojnë oborret e tyre, për të krijuar hapësirat e nevojshme publike. Ky bashkëpunim, sipas Veliajt, ka bërë të mundur që tashmë, edhe fëmijët, të kenë më shumë mundësi të luajnë në hapësira kushtuar atyre. "Ky një është lajm i mirë, sidomos për fëmijët, të cilët do të kenë mundësi të luajnë në hapësirat që kemi rikuperuar nga zaptimet pa leje; do të kenë mundësinë të rriten në një qytet ku mund të luash, ku mund të ndërrosh, ku mund të bësh aktivitet fizik dhe të kesh një jetë të shëndetshme", tha ai. Kryebashkiaku Veliaj garantoi se Bashkia e Tiranës do të vazhdojë të punojë me moton e saj: "Një punë konkrete çdo ditë".



Erion Veliaj gjatë inspektimit të punimeve

Dervishaj-Juraga:

"Linjë ajrore e detare Shqipëri-Kroaci"

Ministri i Transportit dhe Infrastruktura Sokol Dervishaj ka pritur në një takim Ambasadorin e Kroacisë, Sonja Bujas Juraga ku në qendër të takimit ka qenë krijimi i një linje direkte trageti dhe ajrore mes Shqipërisë dhe Kroacisë. Ministri Dervishaj dhe Ambasadorja Juraga, theksuan se marrëdhëniet politike mes dy shteteve janë të shkëlqyera, por duhet bërë më shumë në forcimin e raporteve ekonomike dhe në transport. Ambasadorja Juraga, tha se shumë shpejt Shqipërinë do e vizitojnë përfaqësues të Portit të Rijekës, për të diskutuar nga afër me palën shqiptare për fillimin e një linje direkte trageti, Durrës-Rijeka. Ministri Dervishaj, deklaroi se një nga synimet e tij, është zhvillimi i transportit detar, që ka potencial shumë të madh, por ende të pashfrytëzuar. Ambasadorja Juraga tha se ka interes në rritje nga pala kroate për vendosjen e një linje direkte fluturimi Zagreb-Tiranë.



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

Bulevardi: "Bajram Curri"
Rruga: "Viktor Efremiu",
ish-godina e KESH sh.a.
Tiranë, Shqipëri
Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581
info@ost.al

KËRKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit "toke bujqësore arë" që preken nga **"NDËRTIMI I LINJËS 110 KV, LAÇ-SKURAJ"**.

Subjekti kërkuar në këtë shpronësim është: "OST" SH. A TIRANË.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

Faleminderit.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV SKURAJ - LAÇ

LLOJI I PASURISË SË PALUJTESHME QË SHPRONËSOHET: TOKË ARË, TRUALL, PYLLË, KULLOTE

Nr.	Numri i shtyllës	Emri	PRONËSIA									
			Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Sasia Sip pronës m2	Sipërfaqja e shpronësimit m2	Cmimi i tokës Lek/m2	Vlera e shpronësimit në Lek	Shënime
BASHKIA KURBIN												
FERR SHKOPET												
1	43	Pretendent			Arë	3470	32		15.16	278	4214.5	
Skuraj												
2	49	Gjon	Dode	Preni	Arë + Truall	3469	52	4750	65.87	278	18311.9	Pa çertifikat
MILOT												
3	66	Ismail	Xhemal	Kasmi	Truall	2693	2/52.	818	47.83	278	13296.7	Bashkpronësi
4	68	Pretendent			Arë	2693	40		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
5	69	Pretendent			Arë	2693	156/1		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
6	71	Pretendent			Arë	2693	44/48		47.83	278	13296.7	Nuk ka të dhena
7	72	Pretendent			Arë	2693	55/28 55/29		23.17	278	6441.3	Nuk ka të dhena
8	73	Pretendent			Arë	2693	63/9		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
9	74	Pretendent			Arë	2693	107/6		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
10	75	Pretendent			Arë	2693	108/8		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
11	76	Pretendent			Arë	2693	109/11		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
12	77	Pretendent			Arë	2693	110/6		15.16	278	4214.5	Nuk ka të dhena
13	78	Pretendent			Arë	2693	111/3		47.83	278	13296.7	Nuk ka të dhena
FSHAT LAÇ												
14	80	Pretendent			Arë	2365	113/1		47.83	321	15353.4	Nuk ka të dhena
15	81	Pretendent			Arë	2365	96		16.59	321	5325.4	Nuk ka të dhena
16	82	Pretendent			Arë	2365	96		47.83	321	15353.4	Nuk ka të dhena
17	83	Pretendent			Arë	2365	96		15.16	321	4866.4	Nuk ka të dhena
18	87	Anton	Prend	Miza	Arë	2365	45/31	900	15.16	321	4866.4	
19	88	Preng	Kol	Nezha	Arë	2365	60/2	2030	15.16	321	4866.4	
20	90	Mhill	Vlash	Noka	Arë	2365	60/20	15900	76.98	321	24710.6	Pa çertifikat
21	91	Llesh	Nikoll	Ruka	Arë	2365	56/13	5334	76.98	321	24710.6	Çertifikat
								Σ =	665.50	Σ =	194197.2	

Mungesa e cilësisë, ja karburantet që janë gjobitur

IQT gjobit 22 karburante. Gjobat deri në 2 mln lekë për përmbajtje të squfurit

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

Janë 22 karburantë të cilat janë gjobitur nga Inspektorati Qëndror. Një pjesë e tyre janë gjobitur për shkak se tregtojnë naftë e benzinë jashtë kushteve, ndërsa ka dhe nga ato pika karburantesh që janë gjobitur për mungesë dokumentacioni. IQT ka publikuar listën e plotë të karburantëve të cilat kanë marrë gjoba të ndryshme. Vlera e këtyre gjobave varjon nga 20 mijë deri në 2 milionë lekë të reja. Më shumë janë gjobitur karburantet të cilat tregtojnë naftë e benzinë me nivelin e squfurit më shumë se norma e lejuar si dhe tregtojnë në temperaturë flakërimi më ulët se norma e lejuar. Të gjitha këto karburante janë gjobitur gjatë muajit shtator. "Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) publikon rezultatet e inspektimeve të ushtruara në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe të lëndëve djegëse, pajisjeve nën presion dhe instalimeve elektrike për muajin Shtator 2016. Fokusi i kontroleve të kryera ishte zbatimi i dispozitave të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", ligji nr.32/2016 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve/instalimeve nën presion" si dhe VKM nr.212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës



KARBURANTET E GJOBITURA

5 karburantët që kanë marrë gjoba më të mëdha janë në Fier, Pogradec, Shkodër, Memaliaj dhe në Elbasan. Gjithashtu gjobat janë vendosur edhe për tregtim të gazit jashtë kritereve të përcaktuara në ligj.

(GLN)" dhe ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës te pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar. Nga inspektimet e bëra nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për periudhën Shtator 2016 janë gjobitur 22 subjekte. Më poshtë gjeni listën e subjekteve si dhe informacionin përkatës për secilin subjekt", - thuhet në një njoftim të Inspektoratit Qëndror Teknik.

GJOBAT

5 karburantët që kanë marrë gjoba më të mëdha janë në Fier, Pogradec, Shkodër, Memaliaj dhe në Elbasan. Gjithashtu gjobat janë vendosur edhe për tregtim të gazit jashtë kritereve të përcaktuara në ligj. Në total gjobat kapin një shifër prej 12 milionë e 370 lekë. Bën ë sy se janë vendosur gjoba edhe për mosregjistrimin e pajisjeve, cka shpesh herë sjell abuzime në pistoletet ku hidhet nafta e benzina.

TABELA E SANKSIONEVE TE ISHTI-T PER INSPEKTIMET E PERIUDES SHTATOR 2016

DATA E KONTROLLIT	EMRI I SUBJEKTT	VENDODHJA FIZIKE E OBJEKTIT	TREGUESIT E KONSTATUAR / NATYRA E SHKELJES	MASAT ADMINISTRATIVE	REFERENCA LIGJORE
1.09.16	EURO DRIN TRADING	Memalisht, Pogradec	Temperatura e flakërimit 51.5 °C, nga min 55 °C i lejuar	1,500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 15 pika 6 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "J"
09.09.16	ÇOTAJ	Barbullush, Shkoder	Përmbajtja e squfurit 63.0 mg/kg, nga 10 mg/kg e lejuar	1,500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 15 pika 6 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "J"
09.09.16	KRASNIQI SA	Fier	Përmbajtja e squfurit 63.0 mg/kg, nga 10 mg/kg e lejuar	1,500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 15 pika 6 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "J"
19.09.16	KURUM INTERNATIONAL	Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan	Përmbajtja e squfurit 210.0 mg/kg, nga 10 mg/kg e lejuar	1,500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 14 pika 9 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "g"
07.09.16	GEN-KLAUDIS	Stacione Gega Center GKG shpk Adrese: Rr. G. Muço Lu, Biv. B. Curri Tr, Rr. 3 Deshmoret, Kemishtaj Lu, Rr A. Demi, Antipatrea Br	Përmbajtja e squfurit 295.0 mg/kg, nga 10 mg/kg e lejuar	2,000,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 14 pika 9 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "g"
13.09.16	G.E.E	Kosmaç, Shkoder	Përmbajtja e squfurit 61.7 mg/kg, nga 10 mg/kg e lejuar	1,500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; neni 15 pika 6 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "J"
03.09.16	ROYAL GAZ	Rrajce, Prrerjas, Elbasan	Mbush bombula në kundërshtim me ligjin	500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 4 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "T"
03.09.16	LAURENT	Krahes, Memaliaj	Mos respektim i kushteve teknike për ushtrimin e aktivitetit	500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 1 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "n/iv"
29.09.16	IVEN	Shtoj i Ri, Shkoder	Mungesë Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 7 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "k"
29.09.16	RUKAJ	Koplik, M.Madhe	Mungesë Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 7 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "k"
29.09.16	BOKSI MES	Postribe, Shkoder	Mungesë Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 7 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "k"
29.09.16	J&M LUMAJ	Postribe, Shkoder	Mungesë Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 7 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "k"
21.09.16	DAVA-1	Lagja Çilrim, Berat	Mos respektim i kushteve teknike për ushtrimin e aktivitetit	500,000	Ligji 8450 dt. 24.02.1999 i ndryshuar; NENI 15, PIKA 1 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "n/iv"
05.09.16	Riza Çelanj	Tiranë	Teknikal afati për menjanim shkëlqesh Mungesë	100,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 17, PIKA 1 gërma b
15.09.16	Malido-Energji	Mirditë	dëshmi afatesie punonjësish	50,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 9, PIKA 1 gërma a
16.09.16	Drejtorja nr 2 e puntoreve te qytetit	Tiranë	Mosplotësim kërkesash thelbësore të sigurisë	50,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 3, PIKA 1
20.09.16	IM&AL shpk	Tiranë	Teknikal afati për menjanim shkëlqesh	20,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 17, PIKA 1 gërma b
20.09.16	Ali Dedolli	Tiranë	Teknikal afati për menjanim shkëlqesh	100,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 17, PIKA 1 gërma b
26.09.16	Nderpro shpk	Tiranë	Mungesë dëshmi afatesie punonjësish	50,000	Ligji 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar; NENI 9, PIKA 1 gërma a
02.09.16	HOTEL DYRRAH	Durrës	Mos rregjistrim i pajisjeve	50,000	Ligji nr. 32/2016 dt.24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion" neni 7, pika 1
02.09.16	IVO JORGONI	Durrës	Mos rregjistrim i pajisjeve	50,000	Ligji nr. 32/2016 dt.24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion" neni 7, pika 1
07.09.16	FELLEZE AHMETA	Tiranë	Instalim GLN dhe tregtim pa dokumentacion	500,000	Ligji nr. 32/2016 dt.24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion" neni 9, pika 3
VLERA TOTALE E GJOBAVE				12,370,000 Lek	

UNIVERSITETET/ DUHET TË REGJISTROHENI BRENDA 48 ORËVE. NË 27 TETOR PËRFUNDON AFATI

Janë edhe 5 mijë kuota të lira, regjistrohën 17 mijë studentë

Janë 5 mijë kuota bosh në universitetet publike. Ministria e Arsimit konfirmon zyrtarisht se kur kanë ngelur 48 orë nga përfundimi i regjistrimeve, rreth 5 mijë vende janë ende të paplotësura në universitetet në Tiranë dhe universitetet e rretheve. Gjithashtu Ministria e Arsimit thotë se edhe në universitetet private janë rreth 4500-5000 kuota të lira. Drejtori i Portalit të klasifikimit për maturantët, Arjan Xhelaj thotë se në universitetet publike

janë jergjistruar 80% e maturantëve, pra 17 mijë student të rinj, ndërsa në universitetet private 35%, që do të thotë 4500 studentë. "Në universitetet publike ka 5 mijë kuota bosh, që po vjen duke u zvogëluar numri. Tek privatët pak a shumë i njëjti numër, që do të thotë se regjistrimet tek privati, ka qenë në masën diku tek 25% nuk e ka kaluar masën e vitit të kaluar. Tek publiku është diku 80%. Ka filluar me rreth 22 mijë kuota tek universitetet publike, janë

regjistruar diku 18 mijë. Në qoftë se në private kemi 9 mijë kuota, kemi të regjistruar diku 4 mijë. Universitetet private kanë pasur një metodologji tjetër të përzgjedhjes së studentëve ku u kanë dhënë mundësi të gjithë aplikantëve të bëjnë një konkurs, të shikohet mesatarja. Sistemi është bllokuar të paktën 3 herë, dhe sipas Z Xhelaj kjo ka ndodhur për shkak të fluksit dhe numrit të lartë të aplikimeve pasi në sistem rezultojnë të jenë bërë 13 mln klikime për 12

ditë. Numri i klikimeve në fillim të regjistrimit në datën 13 deri më sot ka arritur 13 milionë", thotë Arjan Xhelaj. Ministria e Arsimit thekson se faza e fundit 48-orëshe, është mundësia e fundit për maturantët që të regjistrohen në Universitet. Në datën 27 tetor do të mbyllet procesi i regjistrimeve. Nëse do të ngelen kuota bosh, Ministria e Arsimit pritet të vendosë nëse do të hapen sërish regjistrimet, apo këto kuota do të ngelen të paplotësura.





Antonio Pennacchi

rrëfen historinë e ‘Kanali Musolini’-t

Është promovuar në Institutin Italian të Kulturës në Tiranë libri i autorit italian



NË FOTO:
Nga takimi për promovimin e romanit 'Kanali Musolini' në Institutin Italian të Kulturës në Tiranë

Është promovuar këtë të martë në Tiranë libri i autorit italian Antonio Pennacchi, "Kanali Musolini". Promovimi u mbajt në Institutin Italian të Kulturës, në praninë e autorit, botuesit Petrit Ymeri dhe dashamirës të letërsisë. Antonio Pennacchi zbuloi para të pranishmëve disa të vërteta të historisë së kanalit të famshëm. Menjëherë pas përkthimit në anglisht libri ngjalli interes dhe admirim për qartësinë e vështrimit dhe stilin në vende të tjera të botës. Libri vjen në gjuhën shqipe nga shtëpia botuese "Dituria". Për të pranishmit Pennacchi rrëfeu zanafillën e romanit, duke theksuar se lidhet edhe me historinë

e familjes së tij.

Historia fillon në vitin 1926 me një njërin prej trashëgimtarëve të familjes Peruci, që ishin argatë venecianë në fund të shekullit të 19-të, ku një fis i tërë fshatarësh nga veriu që vijmë në Agro Pontino për të punuar në tharjen e kënetës.

"Natyrisht në Agro Pontino nuk ekziston asnjë familje Perruci, që t'i kenë ndodhur këto ngjarje, por ngjarjet kanë ekzistuar në të vërtetë. Është historia e komplikuar dhe fatkeqe e atyre që ishin përkrahës e simpatizantë të hershëm të fashizmit. Unë kam treguar histori të vogla, por të vërteta të mëdha të një ekzistencës të madh historik që lihet në harresë

ose që është i komentuar me keqdashje. Nuk e di sesi është ky libër për ju, por unë që kur isha i vogël e kisha vendosur se do ta tregoja".

Përtej kontekstit historik të bonifikimit e kënetave Pontine si një prej projekteve ambicioze të Musolinit, në romanin Kanali Musolini, zbulohen personazhe interesantë. Me një humor dhe ironi të hollë autori shkruan se ç'ishte fashizmi, cila ishte Italia e vërtetë e viteve '30 dhe sesi mund ta njohim Duce ndryshe. Antonio Pennacchi i lindur në vitin 1950 ka qenë edhe pjesë aktive e disa partive në Itali, shpesh kontradiktore me njëra-tjetrën.

AKADEMIA SUEDEZE

"Heshtja e Bob Dylan, veprim i pasjellshëm dhe arrogant"

Ende fituesi i Çmimit Nobel në Letërsi këmbëgjul se nuk do të udhëtojë në Stokholm për të marrë çmimin më 10 dhjetor. "Nëse ai nuk e bën, ceremonia që shënon karrierën e tij do të shkojë përpara siç është planifikuar", thonë përfaqësuesit e Akademisë Suedeze. Kundërshtimi i Bob Dylan-it që ta pranojë Çmimin Nobel në letërsi është veprim "i pasjellshëm dhe arrogant", sipas një anëtarit të Akademisë që që e shpërbleu. Këngëtar 75-vjeçar u emërua fitues i çmimit, javën e kaluar, por, të gjitha përpjekjet e Akademisë Suedeze për të kontaktuar atë kanë dështuar. "Mendoj se është shumë e drejtë të them që reagimi i tij është arrogant e i paedukatë" shprehet Eatsberg për televisionin suedez. Një prononcim për çmimin u

hoq javën e kaluar nga faqja e internetit e Dylan u la të kuptohet se ai nuk do të do të udhëtojë në Stokholm për të marrë çmimin më 10 dhjetor. Një nga anëtarët e Akademisë Eatsberg e quajti këtë gjest mospërfillje "të paparë", kjo të kujton edhe një tjetër person ka refuzuar më parë Çmimin Nobel në Letërsi - autorin dhe filozofi francez Jean-Paul Sartre në vitin 1964. Mediat kujtojnë ndërkohë se edhe autorja Doris Lessing, kishte manifestuar një sjellje shpërfillëse, me të mësuar se ajo kishte fituar çmimin në vitin 2007. Ajo kishte qenë duke bërë shopping dhe pasi ishte kthyer nga pazari, ishte përgjigjur: "Oh Krisht!". Megjithatë, ajo kishte marrë pjesë në ceremoninë e etij viti të organizuar më vonë.



Bob Dylan

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Ekskluzive! Nëna e Matilda Makoçi rrëfen jetën e së bijës
- Ikona e muzikës pop ndahet nga jeta Si ishte katandisur para vdekjes
- Itali, goditet banda e drogës Emrat-Foto/Kapo një shqiptar
- "Hoqa dorë nga kafja për një muaj, e pabesueshme ç'ndodhi me jetën time"
- Shëga antioksidant, mos lini asnjë ditë Tetori pa e shijuar
- Elvana Gjata publikon këngën e re: Rrezikova jetën për të realizuar klipin
- Në SHBA punojnë më shumë se në Europë, ja populli më dembel
- Kokainë tek pulat, kush e priste në Durrës ngarkesën nga Brazil?
- Rama dush të ftohtë deputetëve: S'jeni as në terren, as në seancë
- "Satan 2", raketa ruse që mund të shkatërrtojë një Francë të tërë

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Kushtetuesja pezullon ligjin e Vettingut, e dërgon në Venecia
- VDI/Hoxha shqiptar:Ma mirë me vdek ç'ka, se me u martu me të krishterë
- Pezullimi i Vettingut, SHBA-BE:Të mos vonohet dërgimi në Venecia
- Gara me makina e supershpjtesi në Tiranë, ndëshkohen 9 të rinj
- Në SHBA punojnë më shumë se në Europë, ja populli më dembel

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Audio ku Matilda Makoçi flet për Ramën: Edë, shok i dashur i imi



Përfundon investimi në Farkë,Velaj: Destinacioni i argëtimit në fundjavë

Rama: Pagat e pedagogëve do të rriten siç nuk janë rritur asnjëherë më parë




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

Pezullimi i ligjit të Vettingut vonon zbatimin e Reformës në Drejtësi, jeni dakord me vendimin e Kushtetueses?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.351 KOMENTET E DJESHME

310 727 TOTALI LIKE

DR. NIKE UKGJINI(Institute of Philosophy
and Theology - Shkoder)

Në Podgoricë, Mali i Zi, 21 tetor 2016, u mbajt Konferenca Shkencore Ndërbalkanike, më temë: 1000 vjetori i Shën Gjon Vlladimitrit, organizuar nga Akademia e Shkencave e Mali të Zi e Shqipërisë, me pjesëmarrjen e Akademisë së Bullgarisë dhe Maqedonisë. Në konferencë morën pjesë 22 studiues nga Ballkani, ku shpалосën në gjuhën angleze dhe serbokroate arritjet shkencore më të fundit, për Gjon Vlladimirin dhe rrethanat politike të kohës që kishin mbërthye Ballkanin. Kuntuesit nga Shqipëria, folën për, vendin që zënë Vlladimirin në liturgjinë kishtare shqiptare, restaurimi i Kishës së Shën Gjonit në Elbasan, reliktet e Vlladimitrit në Muzeun Historik etj.. Nga temat e shpalosura, dolën të përbashkëta për Gjon Vlladimirin (970-1016), dhe veprën tij, por dhe dallimet evidente shkencore që ekzistojnë në mes këtyre shteteve në trajtimin e historisë së kësaj periudhe, e sidomos çfarë i përket Mali të Zi dhe Maqedonisë.

Tema, e cila shkaktoi befasi tek malazezet ishte: Kryedioqeza e Tivarit dhe Gjon Vlladimir, ku autori, Dom Nikë Ukgjini, duke u mbështetur në fakte historike, vuri në pah rolin që ka luajtur Kisha katolike në zmbarsjen e ortodoksizmit serb në Diokle si dhe vendet të tjera përreth të banuara me Arbëror. Gjithashtu në ligjëratë u theksua se, Gjon Vlladimir, ishte i pranuar dhe i nderuar prej shqiptarëve deri në maksimumin e duhur, duke ngritur një manastir në nder të tij në Shnjon të Elbasanit në vitin 1381, në krahasim me malazezet e serbet të cilët në shek. XIX, kanë zgjuar interesin për të. Studiuesit në ditën e dytë, vizituan reliktet e Vlladimitrit në Muzeun Historik në Tiranë dhe Kishën e kushtuar Gjon Vlladimitrit në Elbasan. Ishte kjo një konferencë shkencore tejet e rëndësishme në llojin e vet e organizuar pas shumë e shumë dekadash për probleme kaq të ndjeshme ballkanike. Më poshtë sjellim kumtesën e mbajtur nga dr. Nikë Ukgjini.



Kryedioqeza e Tivarit dhe Manastiri i Shën Gjon Vlladimitrit në Krajë

Roli që ka luajtur Kisha katolike në zmbarsjen e ortodoksizmit serb në Diokle si dhe vendet të tjera përreth të banuara me Arbëror. Pse Gjon Vlladimir, ishte i pranuar dhe i nderuar prej shqiptarëve, duke i ngritur edhe një manastir në nder të tij në Shnjon të Elbasanit në vitin 1381...

Provinca Iliro-Romake e Prevalitanës, (Praevalis) trashëgimtare e shteti të Arianinitëve, e cila shtrihet nga Lumi Mat (Mathis) deri në qytetin e Risono (Risan), me kryeqendër Shkodrën, në gjirin e vet përfshinte qytet e njohura: Kotorin, Budvën, Tivarin, Medun, Ulqinin, Lezhën etj.. Kjo provincë e cila si e tillë mbijetoi për dhjetë shekuj, si qendër më të rëndësishme tregtare e politike të saj kishte qytetin e Dioklës (afër Podgoricës së sotme) i themeluar nga mbreti romak Dioklecian (284-305), në shek. e III të kohës së Krishtit.

PRANIMI I KRISHTËRIMIT

Për ta kuptuar më mirë rrjedhat e ngjarjeve mbi temën në fjalë, duhet shtjelluar si pikënisjen e krishterimit në trevat Iliro-Arbërore, ku krishterimi është mbjellë,

nga vet goja e apostujve, për të marrë kështu shqiptarët një drejtim kah një botë më e qytetëruar perëndimore.

Populli shqiptar, si pasardhës të Ilirëve, djeprin e vet e kishin në qytetin Albanopolisë, i cili gjendej në mes Durrësit dhe Krujës apo është vet qyteti i Krujës, gjë që dëshmon vet Ptolomei i cili shqiptaret që në shek. e II të kohës së Krishtit, i ka cilësuar me emrin Albanon.

Për prejardhjen e Arbërore nga popull antik argumentohet nga Polibie, Straboni, Plinie me vonë Fralati dhe në kohën më të re nga studiuesit, Sufllay, Stadtmüller etj.. Gjithashtu është vërtetuar se djeperi i shqiptarëve e ka prejardhjen e vet etnike nga popullata e provincave Ilire: Praevalitana, Dardania, Epiri i Vjetër dhe ai i Ri.

Iliro-shqiptaret të cilët kanë ushtruar besimin në hyjni dhe hyjnesha, si të tillë krishterimin e kanë pranuar që nga koha apostolike, nga Shën Pali dhe nxënësi i tij, Tit. Dëshmi

dhe provë për këtë ngjarje kemi tekstat të Besëlidhjes së Re, tek libri Romakëve, (Rom 15, 19, kah viti 66), ku Shën Palit shprehe se: "Kështu predikova që nga Jerusalemi dhe përreth deri në Ilirik duke kryer detyrën e shpalljes së Lajmit të Gëzuar mbi Krishtin, pastaj kemi librin e Titit (Krh. Tit. 3, 12), dhe Timoteut, (Krh. 2 Tim 4, 10).

Për krishterimin në trevat Iliro-shqiptare, flasin një numër i madh i shkrimtarëve kisharë: Shën Gregori i Nishit (nga Naisus, 334-379). Shën Jeronimi (347-420) nga Stridoni e shumë të tjerë.

Në bazë të dokumenteve të shkruara, mbi zhvillimet e krishterimit në Ilirik janë marrë sistematikisht historianët e njohur si: D. Farlati dhe J. Coleti në veprën "Illyrici Sacri", vëllimet I-VIII. Në vëllimin e VII, botimi i vitit 1817, gjejmë të shënuar emrin e ipeshkvit të parë të Durrësit, Shën Ceasarit, në viti 58. Pastaj kah viti 100 gjejmë emrin e ipeshkvit të dytë të Durrësit, Shën Astit martir, në vitin

Dioklea, duke u bërë qytet i rëndësishëm, që fluar për të marrë pjesë në ipeshkvijtë e vet në koncilin e Kalcedonit të vitit 451, më ipeshkvin Evandrin (Evandrus) në vitin 450. Studiuesit, D. Farlati dhe J. Coleti, në veprën "Illyrici Sacri", vëllimi VII, shqiptojnë edhe emrat të ipeshkvijve, Paulus në vitin 590 dhe të Nemezion në vitin 602. Po kështu përmenden edhe emrat e Metropolitë së Shkodrës ipeshkvi Bassus në vitin 387 etj. Mirëpo historiografia kishare për shkak të pushtimeve sllave, nuk i ka ruajtur emrat ipeshkvijve të tjerë të kësaj dioqeze të cilët veprimtarinë e tyre e kanë ushtruar deri në shekullin XI.

Studiuesi Pavle Mioviq, duke u mbështetur në gurmime arkeologjike, konstaton se Ulqinin ishte si dioqe që në kohën e Justinianin shek. e VI. Po kështu edhe Tivari figuron si dioqe që në shek. VI. ...



Relacionet e kryepeshkvit të Tivarit për manastirin e Gjon Vlladimirit

Konferenca shkencore ndërbalkanike, mbajtur në Podgoricë 21-22 tetor 2016/ Si funksiononte manastiri i "Shën Mërisë së Virgjër" i ngritur nga princi i Diokles, Shën Gjon Vlladimiri (970-1016)...

vijon nga faqja 19

....Në valën e krijimit të dioqezeve të reja, mund të jenë themeluar edhe Shasi, Budva, Kotorri dhe Risan si kryeqendër e mbretërshës Teutë. Kurse, Drishti (Drivasto), në bazë të dokumenteve del si dioqezë në vitin 458. dhe Lezha (Lissus-Alessio) vitin 592.

Për shkak të pushtimit të barbarëve, avarëve dhe sllavëve në shek. VII, të Gadishullin e Ballkanit, ku Praevalitana në vitin 614, ishte shkatërruar, nuk dimë asgjë për fatin e mëtejshëm të dioqezeve në trevat Ilirio- Arbërore deri në Koncilin kishtar të mbajtur në kohën e papa Gjonit VIII (872-882) në Delmitanum (Duvno) në vitin 877, kur Dioklea figuron si kryedioqezë metropolitane duke pasur nën juridiksionin e vete dioqezat: Kotorri, Budva, Tivari, Ulqini, Shasi, Shkodra, Drishti, Pulti, pastaj Serbia, Bosna, Travunia dhe Zahumle.

ORGANIZIMI I ARQIDIOQEZËS SË TIVARIT (ANTIBARENSIS)

Pavarësia e Dioklës në shek. XI-XII, ku mendohet së zgjati për 140 vjet. në aspektin kishtar, donte të thoshte, themelimin i mitropolisë së veçantë të Dioklës.

Me ardhjen në fronin mbretëror të Dioklës, mbretit Konstantin Bodinit (1081-1101), iu drejtua papës të pa ligjëshëm, Klementit III (1080-1100), për riorganizimin e jetës kishtarë në Prevalitanë. Papa Klementi III, më 8 janar të vitit 1089, nxori në Romë bullën "Quia divina pietas" (për shkak të dhembshurisë Hyjnore), drejtuar ipeshkvit të Tivarit, Pjetrit, "Petro Diocliensis sedis Archiepiscopo", (Arqipeshkvit Pjetrit të Selisë së Dioklës), me të cilën themeloi provincën e

veçantë kishtarë për Dioklenë, respektivisht gjallon metropolinë e dikurshme të Dioklës, duke i dhënë një formë të re, mitropolia Diokleato-Tivarase dhe duke i vu nën juridiksion kryesisht dioqezat që i kishte marr në Koncili e Delmitanus vitit 877, me këtë rast duke i shtuar, kishtar me gjithçka që u takonte dhe kuvendet, si të dalmateve, ashtu edhe të grekëve dhe sllavëve. Me këtë rast papati e theksoj dhe dhënien e titullit "Primat i Serbisë". "Më këtë rast filloj një fazë e re e historisë së Kishës në Shqipëri", do shprehej njohësi më i mirë i çështjeve shqiptare, Milan Syllay.

Duke u mbështetur në të kaluarën e Dioklës, del qartë rolin që kishte arqipeshkvia e Tivarit, kur në vitin 1248, papa Inocenti IV, emëron dominikanin e njohur Gjon Plani Karpini, arqipeshkë të Tivarit. Karpini, paraprind një sistemi të ri të Selisë Shenjte, sipas të cilit Shqipëria behët baza e operacioneve kundër Ortodoksisë në Ballkan. Dhe Tivari shtabi kryesor kundër depërimit të kishës ortodokse në bregdet. Mbretëria Serbe edhe pse në vitin 1219, e kishte krijuar Kishën Serbe autoqefale mbretërit Serb, edhe përkundrejt këtij veprimi, për ta fituar kurorën mbretërore nga Selia e Shenjte, gjithmonë janë tërësisht në titullin Diokles se Vjetër, duke përfshirë edhe Stefan Vladislavin (1231-1243). Këtu ndërpritet tradita e mbretërisë së Diokleatë dhe fillon një kohë e trazimeve madje dhe armiqësore në mes mbretërisë serbe me Selisë Shenjte. Kjo gjë u vrenjtë më së tepërmi gjatë sundimit të Stefan Dushanit pushtues, (1331-1355), mbreti i serbëve dhe i vetëshpallur, mbret i Rumelisë, Shqipërisë dhe Greqisë, i cili haptazi kërkonte konvertimin e katolikëve në ortodokse.

Serbët në kohën e Dushanit, por dhe më parë, për të përhapur sa më tepër besimin ortodoks të nacionalitetit të tyre, ndërtonin kisha dhe manastire serbe, në themelet e kishave dhe manastireve katolike në Malin e Zi të sotëm, Shqipëri, Dardani (Kosovë) e më gjerë, çfarë hasi në kundërshtim të madhe të arqipeshkvit të Tivarit, dominikanit francez, Guillelmo Andre (1324-1341) i cili shkruanet e tij, "Directorium ad passium faciendum", të vitit 1332, fton fuqitë evropiane që ushtarakisht të kundërshtojnë Stefan Dushanin. Kjo armiqësi zgjati deri me ardhjen në pushtet të princërve të Ballshajve (1360-1421) me qendër në Shkodër të cilët e rikthejnë besimin katolike si besim zyrtar në gjithë mbretërinë e Dioklës.

MARRËDHËNIET E ARQIPESHKVISË SË DIOKLIATË E TIVARASE ME MANASTIRIN TË "ZOJËS SË VIRGJËR" NË KRAHINËN E KRAJËS

Duke pasur parasysh se Greqia, Shqipëria e Dalmacia kanë qenë vende të organizuara mirë në



aspektin e krishterimit, urdhrat të lindur në shek. IV e në vazhdim, si: të eremitëve, agustinianve, bazelianëve e benediktinëve, etj, kishin gjetur hapësirën e duhur edhe në trevat të Prevalitaës. Monastiret (kuvendet) të Dioklës, si trevë Ilirio- Arbërore, janë të lidhura zinxhirë me monastiret e vjetra të kohës së Shën Benediktit, shek. VI si: i Shën Marisë të Budves, monastirin e Shëlbueimit (Santi Salvatoris) në Tivar dhe Shën Bachut dhe Sergio në Oblik të Bunës dhe zonat të tjera të Shqipërisë. Pastaj në shek. XIII, kjo hapësirë u vërshoi me urdhrat nga perëndimi si: Domenikanet, në Kotorr, Durrës, Shkodër e Ulqin, dhe që merreshin me hapjen e shkollave dhe universiteteve; Françeskanet me kuvendet e tyre në Kotor, Tivar, Shkodër, Ulqin e në disa qendra të tjera dhe Karmelitanët në Ulqin, Shas dhe Shkodër. E gjithë puna në këto kuvende zhvillohej nën moton e Shën Benediktit: "Ora et labora" – lutu dhe puno.

Në mesjetë kemi edhe abacitë në rrethin e Tivarit të Shën Marrisë, Rataci (Roteca) i shek. XI, abacinë e Shëlbueimit (Santi Salvatoris) në Tivar i ringritur në shek XII. Në dokumente dalin dhe shumë kuvende murgjish, në shek. XIII, të ndërtaur jasht mureve të kalas. Në dioqezën e Ulqinit kemi të evidentuar abacin e Shën Nikollës në lumin Buna (1346) shek. XIV, në dioqezën e Shkodrës, kemi abacinë e Shirqit dhe Bakut (Sergius et Bacchus) në Oblik, buzë lumit Buna, i ringritur në shek. XIII dhe abacin e Shën Gjonit në Rushkull, Shtoj i sotëm në afërsi të Shkodrës e shek. XI.

Ndërtimi i abacive dhe kuvendeve në Arqidioqezën e Dioklës dhe Tivarit si dhe dioqezat sfragane, janë vepra të mbretërshes katolike Helena e cila në shek. XIII, cilësohej si mbretëreshë e Dioklës, Serbisë dhe Shqipërisë.

Në këto pjesë të Shqipërisë veriore ku janë financuar ndërtimet e objekteve, edhe pse në të kaluarën kanë qenë nën pushtimin serb, kjo zonë asnjë herë nuk ka ndryshuar besimin dhe as gjuhën e tyre shqipe, do shprehej Theodor Ippen.

RELACIONET I KRYEPESHKVIT TIVARIT, PËR MONASTIRIN E GJON VLLADIMIRIT

Në kohën e betejave sllave për Dioklen, krahas manastireve (kuvende) ekzistuese, funksiononte manastiri dhe që ishte kushtuar "Shën Mërisë Virgjër" dhe gjendej rreze liqenit të Shkodrës në krahinën e Krajës, në fshatin Ostros i vogël, apo Kranj, në zonën e Arbëshit, Ky manastir i "Marisë Virgjër", sipas Shyflay, dhe disa autorëve të tjerë është ngritur në shek. X, dhe është ndërtuar nga

NË FOTO:
Gjatë ditëve të konferencës së mbajtur nga Akademia e Shkencave të Malit të Zi dhe në Elbasan





princi i Diokles, Shën Gjon Vladimiri (970-1016) Shënime të detajuara dhe shumë të dobishme për historiografinë shqiptare dhe sllave janë ato të kryepeshkvit, të Tivartit, Gregori me veprën e tij "Sclavorum Regnum" e shkruar ndërmjet vitit 1177-1189. Autori në fjalë jep përshkrimet të detajuara për pushtimet sllave, në provincën e Prevalitanes, pagëzimit të tyre si dhe luftërave që zhvilloheshin ndërmjet sllave dhe me pas më Bizantin për marrjen e fronit mbretërorë të Dioklës. Në vargun e gjithë emrave që benë histori është dhe Shën Gjon Vladimiri dhe manastiri i Shën Marisë Virgjërë, ku autori në fjalë ia kushton një kapitull i veçantë.

Sipas kronikës së lart cituar, princi i Dioklës, Shën Gjon Vladimiri, në vitin 997, më gjithë qenien e tij luftoi në mbrojtjen e Dioklës nga Bullgarët, dhe jeta e Vladimirit kishte përfunduar nga një tradhti e kurdur, në mënyrë tragjike duke iu pre koka nga mbreti Jovan Vladislav, me 20 maj, në vitin 1016 në Prespa të Bullgarisë. Kronika vazhdon, së trupi i tij, më vonë që sjell në manastirin e Shën Marisë në krahinën e Krajës, për tu rivarrosur nga e bashkëshortja Kosara, ku me vonë edhe ajo në vitin 1018, që varrosur në të njëjtin vend më bashkëshortin e saj Vladimirin.

Në kronikat dhe legjendat të më vonshme të shek. XVI e në vazhdimë, ku pas tre shekujve heshtje përgojohet Gjon Vladimiri, mësohet se trupi i tij që marr në vitin 1215 nga Kraja nga princi Epirot despoti, Mihail Engjelli Komnena (1204-1216) dhe që dërguar në Durrës në ruajtje. Dhe në 1381, sipas burimeve studimore eshtrat e shenjtë janë sistemuar në Elbasan në Shqipëri, në manastirin e rindërtuar, nga princi i Shqipërisë nga Karlo Topia, (1359-1383), kushtuar në emrin e Shën Gjon Vladimirit.

Nuk ka dyshime se ky është burimi me autentik dhe më i rëndësishëm i shkruar nga kryepeshkvi katolik i Tivartit Gregori, për ekzistencën e Kuvendit në fjalë dhe shenjtërit popullor Gjon Vladimiri.

Studiuesit e më vonshëm, edhe pse për rrjedhën e ngjarjes së Vladimirit, ngrahin shumë pyetje më të drejt apo jo, si: Jireček, Radonić, Mijušković, Antoljak, Perićić.

Krahas pyetjeve që shtrohen nga studiuesit, për vendvarrimin, pozicionin e tij në shoqëri apo marrja emrit Gjon e tjerë, ajo për muaj çfarë do ishte pyetja më intriguese është, perse trupi i tij u mor nga Kraja, duke

u sjell në Durrës e pastaj në Elbasan?

Jireček, hedh hipotezën, se eshtrat e Vladimirit janë marr në ruajtje nga frika e grabitjes nga hungarezët, bullgarët etj., që synonin për ta sulmuar Dioklen, dhe se çdo popull ka pasur dëshirë të kenë reliket e ndonjë shenjtërit. Ndërsa, Banašević, shprehet se serbet kanë pasur mundësin ta rikthejnë trupin e tij nga Shqipëria, por kanë pasur interesin më të madh për Shën Sava Nemanjić, theme-lues i Kishës Ortodokse në vitin 1219, si shenjtë e identifikimit të tyre kishtar dhe shtetërorë. Argumente të kësaj natyre hipote-tike mund të rreshtohen edhe të tjera.

Njohësi i mirë i historisë shqiptare Milan Šufflay, shprehet se Perandoria Romake me pushtime, në Prevalitan, kishte shpërndarë fiset ilire primare si: Labeatet, Pirustet, Sardatet etj, deri në rigjallërimin e fiseve sekondare. Vazhdimësia e gjakut Ilir, sipas burimeve bizantine, shpërthejnë dukshëm në shek. XI, me emrin Albanoi, po më të njëjtin emër Albanoi që Ptolomeut në shek. e II, i përmend shqiptaret. Po në shek. e XI, kemi rizgjim të principatave të Arbrit, në Bizant të cilat që në këtë kohë ishin zhvilluar fuqishëm si struktura politike autonome.

Në fushën kishtarë shqiptare, kemi në vitin 1065, në pallatin papnor të Romës, kardinalin Bonifatius Albanensis (Albanin), kur për të parën herë një funksionar i lart papnor del më mbiemrin e një nacionaliteti, me këtë rast shqiptar. Në vitin 1062, dioqeja e Arbrit (Arbanensis) në bullën e Papa Aleksandrit të II, figuron si sufragane Antibarisanis. Pastaj në ceremoninë e inaugurimit të Katedrales se Kotorit në vitin 1166, kemi pjesë-marrjen aktive të ipeshkvit të Arbërisë, episcopis Lazaro Arbanensis dhe abatis të manastirit të "Sanctis Salvatoris Arbanensis" (Të Shëlbuesit në Arbëri) Gjergjin. Me emrin Albanensis, shënohet dhe pjesëmarrja në Koncili të Tivartit në vitin 1199, etj. Si shqiptare kishin gjuhën e tyre shumë aktive, është rasti kur gjuha shqipe në mënyrë të drejtpërdrejtë përmendet për të parën herë në vitin 1285, jashtë trevave shqiptare në Dubrovnik, do shprehej Šufflay. Pastaj, Shqipëria si shtrirje gjeografike, në shënimet papnore, si, "Regnum Albanie" llogaritet duke filluar nga Gjiri i Kotorit e duke vazhduar më pas lumi Drilone (Drini i Matit) në Epirin e Ri e në vazhdim. Kurse, Arqipeshkvia e Tivartit si institucion kishtar, në relacionet e Selisë se Shenjte, nga Marin Bici, 1610, deri tek Karlo Pooten 1867, gjithmonë është eidentuar si pjesë trojeve të Arbërisë (Albania).

Nga keto dhe shënime të tjera del se banoret e Diokles, në fakt ishin shqiptarë të vjetër, të cilët nën presionin e fiseve sllave u tkurën dhe një pjesë u asimiluan duke kaluar në nacionalitetin sllav dhe më vonë në ortodoksin serbe. Prandaj, më të drejt, Šufflay, do shprehej, se „Zeta (Dioklea), dhe Shqipëria Veriore, krijojnë një facies biologjik të përbashkët, të lidhur me troje e më gjakun Ilir dhe më një histori të dhimbshme“.

Nisur nga këto fakte, princat e Arbrit, duke qenë se në fillim të shek. XII, ishin në pozicione favorizuese politike karshi bizantin, morën trupim e Vladimirin që rrezikohet në krahinën e Krajës nga grabitësit, për ta sistemuar në Durrës e më pas në Elbasan. Kjo edhe për vet faktin se shqiptaret e ndienin Vladimirin si pjesë të pandashme e historisë së tyre i cili veprë në trevat e Diokles.

Kisha Serbe, për ta pasur si një pik reference për të ardhmen, në këtë kuvend instaloi një grup kallogjerësh të cilët më vonë u perhapen edhe në kishat e liqenit të Shkodrës të ndërtuar nga Ballshajt. Kurse arqipeshkvia e Tivartit u përqendrua tek

besimtaret katolik shqiptare "që ishin një shumicë e fuqishme në krahinën e Krajës, thotë Šufflay.

Kraja, në relacionet e Romës, papritmas mori një vemendje të posaçme, me rastin e krijimit të një Kryedioqeze të re më të njëjtin emër. Arqipeshkvia e krahinës s Krajës (Archiepiscopus Crainensis) ishte jetë gjatë nga viti 1446-1480. Por, sipas gjasave, ky aksion nga papati është ndermarr, për ta frenuar ekspansionizmin e Kishës Serbe, në këtë zonë të banuar më shqiptar. Si ipeshkvë i tret në krye të kësaj Selie në vitin 1454-1457, ishte shqiptari, Pal Dushnani, i cili sipas Šufflay, shquhej si person i jashtëzakonshëm.

Relatori Marin Bici, me rastin vitës së tij në vitin 1608, në trevat shqiptare të pushtuara nga Osmanet, flet për përhapjen e ortodoksisë në kryedioqezën Tivartit e cila kryhej edhe më ndihmën Perandorisë osmane. Po kështu flasin edhe relatorët të tjerë si: Françesko Leonadro, në vitin 1633, Gjergj Bardhi, në vitin 1637 dhe Andria Zmajeviq në vitin 1671. Relatori që jep një indikacion të shkurtër për manastirin e Vladimirit, pas shumë vitesh, ishte ipeshkvi i Shkodrës dhe administratori i Tivartit Pjeter Bogdanit (1656-1677). Në kohën e tij, shihet një zbutje e situatës në mes dy kishave për shkak të përpjekjes së krijimit të një aleance të krishterë kundër Perandorisë osmane. Kjo ide reflektohet edhe të Bodgani si njeri më brilant i shqiptarëve të gjitha kohërave. Ai në vitin 1667, tregonte një pjekuri shpirtërore më kallogjerët ortodoks, duke u kujdesur pran Selisë Shenjte, për tu ndihmuar më orendi kishtar dhe flamuj kishtar, manastiret tek Liqeni i Shkodrës, të Shën Nikollës në Vraninë, Lahovë dhe Krajë. Po në këtë relacion mësohet se në manastirin e Rahovës dhe Krajës, qëndronin vetëm nga një kallogjer.

Relatori që jep shënime pak më të zgjeruar për manastirin Gjon Vladimirit është kryepeshvi i Tivartit Marko Giora, gjatë vizitës së bërë në këtë zonë në vitin 1697.

Giora në fillimi flet për historikun e lavdishme që ka pasur kjo kryedioqeze, kur ka lulëzuar me kisha të bollshme e të bukura dhe kishte 72, familje fisnore. Gjithashtu flet për besimtaret e kishave që tani si pasojë konvertimeve, shumë janë zvogëluar.

Në krahinën e Krajës, për të cilën jemi duke bërë fjalë, relatori përmend famullinë e Ljarës se Lartë dhe të Ulet, ku qëndronin 29 familje katolike shqiptare, 2 familje turke (shqiptar të islamizuar) dhe 7 shtëpi serbe. Shëstani cilësohej si famulli shumë e madhe dhe ishte më shtëpi dhe kisha gjysmë të rrënuar nga plaçkitjet malazeze. Numri i besimtarëve ishte në 756, dhe me dy shtëpi turke dhe 6 shtëpi serbe më 40 banor. Relatori pastaj flet për gjendjen edhe në famullit të tjera.

Marko Giora, raporton për Krajën (Craina) që i takonte arqipeshkisë së Tivartit ku ekzistonte manastiri (kuvendi), kushtuar "Ngjitjes Madhështore të Zojes së Bekuar Virgjër në Qiell", të cilën banorët e nderonin shumë në ditën e festës së saj edhe vetë shqiptaret muhamedanët. "Këtë manastir dhe Kishë", thotë arqipeshkvi Marko, "e mbajnë dhe në të shërbëjnë kallogjerët ose monarkët serbë, pastë kështu manastir kishtar e mbanin tradicionalisht ata (kallogjerët). Giora vazhdon se "pa marrë parasysh këtë (se këtu ishin kallogjerët), edhe meshtarëve tanë u lejojnë që ata të kremtojnë Meshën Shenjte, pasi edhe unë e ata rastin, që brenda saj të kremtoja si dhe më paraardhësin tim, (Andria) Zmajeviqin." Meshën Shenjte, përfundon raportin i viti 1697. Se devocioni për Gjon Vladimirit ka ekzistuar të shqiptaret, tregon dhe fakti kur Mons. Vincenc Zmajeviqi, në relacionin e tij të viti 1703, thekson se, në famullin e Shasit, në fshatin Sumë ka qenë ngjitur një Kishë katolike në nderim të Shën Gjon Vladimirit. Ky relacion si dhe relacionet e tjera të mëparshme, ku pohohet se kjo zonë ka qenë vazhdimisht e populluar me shqiptare katolik dhe shqiptar mysliman, të çon tek përfundimi se manastiri i Gjon Vladimirit ishte, ndërtuar për nevojë të Kishës katolike e jo të asaj serbe apo të mbretërisë se Zetës së më vonshme. Këtë e dëshmon dhe Theodor Ippen, duke u shprehur, se, në Ostros ka mbeturina të Kishës më përmasa mjaft të mëdha më një kamberanë të mbajtur mjaft mire dhe Kisha sipas ndërtimit është e stilit perëndimor e jo lindor. Për shkak të këtij komplecteti historike, Shën Gjon Vladimiri më të drejt mbetet një shenjtëri i nderuar nga tri besimet dhe disa nacionalitete ballkanike, që dëshën apo nuk dëshën, janë të gjykuar të jetojnë s bashku në këtë qall, herë pas herë të vrenjtur të Gadishullit të Ballkanit.





KATEGORIA SUPERIORE

JAVA 9

TË SHUTUNËN

■ Kukësi-Luftëtari 14:00

TË DIELËN

■ Flamurtari-Korabi 14:00

■ Teuta-Laçi 14:00

■ Partizani-Skënderbeu 17:00

TË HËNËN

■ Tirana-Vllaznia 18:00

ndeshjen Kukësi-Luftëtari në orën 14:00. Te dielën, në të njëjtin orar zhvillohen edhe sfidat Flamurtari-Korabi dhe Teuta-Laçi, dy duela të drejtë për drejta në luftën për mbijetesën mes më të mirëve.

IKËN BERTONI
NGA PARTIZANI

Luca Bertoni largohet nga Partizani. Njëpërjet një komunikate zyrtare klubi i kuq njofton nëprerjen me mirëkuptim të marrëdhënieve kontraktuale me mesfushorin italian, i cili mbërriti të të kuqtë gjatë merkatos së verës në formë huazimi nga Sudtiroli i sugjeruar nga Adolfo Sormani. 24-vjeçari u aktivizua në vetëm 4 ndeshje, por pa mundur të lërë gjurmë në lojën e të kuqeve. Ndërkohë Partizani do të udhëtojë drejt Lezhës për Kupë me mendjen te supersfida e javës së fundit të fazës së parë me Skënderbeun në "Elbasan Arena".

Partizani-Skënderbeu të dielën në 'Elbasan Arena'

Mbyllja e "Selman Stërmasit" për rregullimin e fushës, nuk lejon zhvillimin në Tiranë të supersfidës

Ndryshon kalendari i javës së 9-të të Kategorisë Superiore, që do të mbyllë edhe fazën e parë. Për shkak të problemeve me tapetin e stadiumit "Selman Stërmasi", supersfida ndërmjet Partizanit dhe Skënderbeut do të zhvillohet të dielën në orën 17:00 në "Elbasan Arena". Fillimisht ai që cilësohet si dueli direkt për titullin ishte parashikuar të luhej të hënën në orën 18:00 në kryeqytet, por mbyllja e detyrueshme e stadiumit të Tiranës ka bërë që ndeshja të spostohet në Elbasan. Duke vlerësuar vendimin e Federatës së Futbollit për të ndryshuar stadiumin, drejtuesit e Partizanit kanë kërkuar edhe zhvillimin e ndeshjes të dielën. Kjo për të shfrytëzuar pushimin e fundjavës dhe për të mundësuar që tifozët e kuq të jenë të

pranishëm në numër të madh, pavarësisht se përballja do të luhet jashtë kryeqytetit. Nga

problemet e konfirmuara me fushën preket edhe vetë Tirana, që sfidën klasike me Vllazninë de-

tyrohet ta luajë të hënën, në orën 18:00. Stadiumi Selman Stërmasi nuk do të jetë gati as për këtë

ndeshje, që gjithashtu pritet të luhet në Elbasan Arena, megjithatë klubet janë në pritje të një

vendimi përfundimtar. Për sa i takon takimeve të tjera, java e 9-të do të hapet të shtunën me



Carlos Alberto

HUMBJA

Ndërron jetë ish-kapiteni i Brazilit, Carlos Alberto

Futbolli në zi, në moshën 72 vjeçare u shua në Rio de Janeiro si pasojë e një infarkti, një prej emrave legjendarë të tij, Carlos Alberto, ish-kapiteni i Brazilit të vitit 1970, që konsiderohet si një prej skuadrave më të bukura të të gjitha kohërave. Carlos Alberto konsiderohej nga të gjithë si një prej lojtarëve të krahut më të mirë të të gjitha kohërave dhe goli i tij në finalen 4-1 me Italinë në Botërorin mexikan do të kujtohet gjatë si një prej realizimeve më madhështorë në historinë e lojës, përpara se vetë ai të ngrinte drejt qiellit Kupën "Julet Rimet", të cilën në atë edicion Brazili arriti ta bënte përfundimisht të tijën duke qenë

se fitonte për herë të 3-të titullin. Një lojtar i jashtëzakonshëm, me një karrierë po kaq të jashtëzakonshme, gjatë së cilës veshi fanellat e Fluminense, Santosit, Botafogos, Flamengos por dhe New York Cosmos, ku mbylli përfundimisht dhe karrierën duke luajtur përkrahë Pele-s por dhe Beckenbauer, që u bë njëri prej miqve të tij më të mirë. Carlos Alberto provoi gjithashtu me sukses dhe karrierën si trajner duke fituar titullin brazilian në vitin 1983 me Flamengo, ndërsa në 1993 me Botafogon fitoi Kupën e Conmebolit në Amerikën e Jugut, e ngjashme me Kupën Uefa në Europën e atyre viteve. Carlos Alberto është

qenë pjesë e formacionit më të mirë të Fifa-s për shekullin e 20-të, ndërsa bën pjesë në listën e 100 lojtarëve më të mirë të Fifas dhe emri i tij është përfshirë gjithashtu dhe në Hall of Fame të Futbollit brazilian. Ish-kapiteni i kombëtares braziliane të futbollit, Carlos Alberto, ka ndërruar jetë në moshën 72-vjeçare, pas një ataku në zemër. Alberto ka qenë kapiten i Brazilit që fitoi Kupën e Botës në vitin 1970 dhe autori i golit të katërt në finalen e famshme ndaj Italisë. Mbrojtësi ka luajtur 53 ndeshje me Seleçon, duke shënuar 8 gola. Edhe si trajner ai ka qenë i suksesshëm në drejtimin e skuadrave si Flamengo dhe Botafogo.

Shkurt

Largimi

Magani ikën nga Flamurtari do drejtojë Teutën

Pas mëse një jave pritjeje dhe negociatash, marrëveshja mes Flamurtarit dhe trajnerit Gugash Maganit ka përfunduar. Ai nuk do të jetë më trajneri i Flamurtarit, por nga dita e enjte do të prezantohet si trajneri i Teutës. Pas një periudhe të suksesshme në Durrës sezonin e shkuar, largimi i tij për tek skuadra vlonjate nuk ka funksionuar dhe kjo për shkak të problemeve financiare të lindura që në fillim të këtij sezoni. Njëpërjet një sms-je trajneri Magani ka njoftuar largimin duke mos dhënë asnjë arsye publike. Prapaskanat e këtij largimi lidhen me problemet financiare që ka skuadra vlonjate, e cila është futur në një situatë kaosi ku veç trajnerit janë dhe shumë lojtarë që kërcënojnë me largime apo hedhje në gjyq, sepse nuk paguhen që nga muaji korrik. Aktualisht skuadrën e Flamurtarit do ta drejtojë Gentian Mezzani. Ndërkohë që ai të përket Maganit ai me sa duket ka rënë dakord për t'u rikthyer në Durrës duke mos humbur kohë në rikthimin e tij aktiv në Superligë.



Angli

Mourinho "kriset" me Rooney: "Wayne, mund të largohesh"

Jose Mourinho i hap dyert e largimit nga Manchester United sulmuesit Wayne Rooney. Marrëdhënia mes trajnerit dhe lojtarit vijon të jetë ende e ndërë pasi Rooney nuk është titullar në ndeshjet e fundit dhe nuk do të jetë. Sulmuesi pas kësaj situatë të krijuar po mendon për të ardhmen e tij dhe sipas mediave britanike Mourinho i ka bërë me dije Rooney se mund të largohet. "Wayne, mund të largohesh" titullon Sun Sport në faqe të parë duke e bërë më e evidente distancën e krijuar mes 31-vjeçarit dhe trajnerit portugez. Mourinho i ka thënë Rooney se nuk mund t'i sigurojë një vend në formacionin titullar. Në këtë mënyrë pas 12 vitesh në "Old Traford", 532 ndeshjesh dhe 246 golash të shënuar Rooney mund të largohet nga United. E ardhmja e Wayne Rooney mund të jetë në Amerikë apo Kinë.



Trajneri


Pasuesi i Jupit tek Shpresat, FSHF shtyn vendimin

Takimi i parë i Presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit Armand Duka dhe stafit të tij teknik të federatës nuk ka nxjerrë asgjë konkrete sa i përket kandidatit për postin e trajnerit të përfaqësueses U21 i lënë bosh nga përfundimi i kontratës së Redi Jupit. Janë përfolur këto ditë emrat e dy pjesëtarëve të stafit kuqezi ish-lojtarë e kombëtares Alban Bushi, aktualisht menaxher i kombëtares dhe Erjon Bogdani ndihmës i De Biasi-t. Veç tyre ekziston mundësia e spostimit të trajnerit të kombëtares U17, Xhemal Mustedanagiq, një i preferuar i Presidentit Duka, por ende asgjë konkrete. I ngarkuar për gjetjen e trajnerëve të huaj, më saktë italian, është Paolo Tramezzani, por problemi kryesor me të huajt është oferta jo shumë e lartë financiare që FSHF mund të japë për trajnerin e kombëtares U21. Nga takimi i fundit presidenti Duka ka kërkuar më shumë kohë për të zgjedhur këtë trajner dhe me shumë gjasë vendimi do të merret pas ndeshjes me Izraelin.



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 37 KUTI




HORIZONTAL

- Një pjesë e gastareve
- Qytet në Kaliforni.
- Fillojnë matjet
- Telo... e Violeta Manushit.
- Mund të jenë parabolike.
- Ishtin hermitë si Simeoni.
- Fare pa fe.
- Një... caffè per passione.
- Film i Peter Bogdanovich.
- Qe mbreti i elfëve.
- Një sportist si Kostandin Grillo.
- Kalohen në gjumë
- Kryeqyteti i Timurlengut.
- Janë anët e dritarës.
- Qendër kurimi.
- Një lloj njeriu.
- Eshhtë ushtar i partisë
- Ente Prodhuese Elbasan.
- Ka kryeqendër Winnipeg.
- Dy anët e detit.
- Sastre aktore
- Keshu na si që s'pajuan.
- Një hyjtë të ozalit.
- Fillojnë lidhjen.
- Janë në masë
- Mbyllin akte.
- Dy asa
- Hooker i famshëm i blues.
- Janë teologë islamikë.
- Një diamant artificial.
- Eshhtë i privuar nga liria.

VERTIKAL

- Leroux i Fantazma e

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË



Operas.


- Gjysmë pasimi.
- Pop... i Andy Warhol.
- Nuk ka skeptiku.
- Bëjnë arte me re.
- Mund të jenë barok e liberty.
- Pak paqësore.
- Sophia e kinemasë
- E famshme ajo Gordiane.
- Hercule i Agatha Christie.
- Forman i Amadeus
- Lala ish-mesfushor
- Carson i fumet-it
- Kufijtë e Holandës.

7. Teket e sallës.

- Lokali me me cowboy.
- Agjenci Grumbullimi
- Tiranë.
- Keshu thirrje Eddy
- Merckx
- Fillojnë daljen
- Harris aktor.
- Paguhet për vonesë.
- Tommy... Jones aktor.
- Fillojnë natën
- Një ishite dhe Poseidoni.
- Na... shihni në pasqyre.
- Ente Ndërtimi Korçë.
- Kufizojnë takimet.

- Fundi i një fatzui.
- Anita pianiste.
- Pak amatoriale
- Qe dekrete i sulltanit
- Lumë në Gjermani.
- Organizma Tregtare
- Durrës.
- Ruhën në fund.
- Ndjek një Re.
- Fillojnë matanë.
- Zanorë për kosovar.
- Sampiras ish-tenist.
- Mbyllin fushatat
- Nino Rota.
- Qe monedhë spanjolle.

FJALËKRYQI SPORTIV



PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



HORIZONTAL

- Një trofe sportiv.
- Vihen edhe me skedina.
- Pak amatoriale.
- John kangëtar.
- Një finale e futbollit amerikan.
- Gjysma e tagrit.
- Një Pal dikur futbollit i ynë.
- Erani teniste.
- Një fjalë si lart.
- E famshme Curie.
- Të parat në pistë.
- Daja trainer.
- Janë bjeshtë.
- Rastisin në krye.

- Numra pa zë.
- Sapo fillojnë.
- Gjysma e armave.
- Gjysma e stilit.
- Inicialet e Einstein.
- Një Khan i ismailitëve
- Sleiger aktor.
- Në krye të skuadrës.
- Ndal në ekstreme.
- Personazhi në foto.
- Personazhi në foto.
- Fillojnë nisen.

VERTIKAL

- Duhet të jepen të sakta.
- Një paguhet për parabeleje.
- Një fjalë si gjithmonë.
- Eshhtë birmë që bëhet edhe... kafe.
- Loja me strikë.
- Bëjnë kanal me një ka.
- Ishte futboll i Holandës.
- Agimi, që qe bomber i Partizanit.
- Fillojnë torturën.
- Besim pa kufij.
- Skuadër greke.
- Fitohet nga i pari
- Titulli i Alex Ferguson
- Luajnë marshë.
- Besim pa kufij.
- Pak marmarendëse.
- Kufijtë e pjesës.
- Gjysma e tagrit.
- Alessandro te Sassuolo.
- Skuadër e Spalletti-t
- jeans përurë.
- Oerter që hichte diskun.
- Një djallë i Noes.
- Rastis në kufij.
- Targa e Zvicrës
- Qendër në tour.
- Inicialet e Montolivo-s.
- Të parat në slalom.

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË
MËNYRË QË ÇDO RRESHT E
KOLONË TË KETË NUMRAT NGJA 1-9

PËRGJIGJE

9	6	3	8	1	5	7	4	2
1	4	2	3	9	7	5	6	8
5	8	7	2	6	4	1	9	3
6	2	1	4	3	9	8	5	7
3	7	8	6	5	2	4	1	9
4	9	5	1	7	8	2	3	6
2	1	9	7	4	6	3	8	5
7	3	6	5	8	1	9	2	4
8	5	4	9	2	3	6	7	1

4	1	8	5	6	2
2	6		5	4	
7		4	2	6	3
	1	7		4	2
5					7
	6	4		3	1
3			7	5	1
6	5			2	1
1	9	2	3	7	8

HROS KOPI

DASHI

Klima yjore nuk do jete shume e pershtatshme per një ambient te qete ne çift. Shume gjere do ecin ndryshe nga sa mund ta kshih menduar dhe mund te ndiheni keq ne disa momente. Beqaret, te ndikuar tej mase nga Hëna, do jene sharmante dhe joshës. Me siguri qe do gjejne personin e pershtatshëm. Sektori i financave do stabilizohet tej mase keshu qe mund te bëni edhe investime.

LUANI

Ka mundësi te mbylleni ne vetvete sot ju te dashuruarit dhe nuk do ja shprehi asnjë lloj ndryshimi. Ne kohën e lirë mund te merren edhe me ndonjë aktivitet te përballshëm. Beqaret do jene me shume fat ne dashuri dhe do mundin te takojnë personin për te cilin kane thurur kaq shume ëndrra. Ne planin financiar do jete mire te tregoheni me te matur me shpenzimet sepe situata mund t'u dale jashtë kontrollit.

SHIGJETARI

Çiftet do ndihen mire ashtu si janë dhe nuk do preferojnë te bëjnë asnjë lloj ndryshimi. Ne kohën e lirë mund te merren edhe me ndonjë aktivitet te përballshëm. Beqaret do jene me shume fat ne dashuri dhe do mundin te takojnë personin për te cilin kane thurur kaq shume ëndrra. Ne planin financiar do jete mire te tregoheni me te matur me shpenzimet sepe situata mund t'u dale jashtë kontrollit.

DEMI

Mos kërkoni me shume pavarësi nga sa duhet sot ju te dashuruarit sepe atëherë kur nuk do e prisni situata mund t'u dale jashtë kontrollit. Beqaret do fillojnë lidhje sfatgjata te cilat do ua ndryshojnë jetën njerërore e përgjithmonë. E shkruar e trishtuar do harrohet përgjithmonë. Financat duhet t'i keni gjithë kohës nën kontroll qe gjendja te mbetet e qëndrueshme.

VIRGJËRESHA

Do jeni shume te drejtpërdrejtë sot ju te dashuruarit dhe do ja bëni partnerit edhe disa kritika qe me pare nuk keni mundur dot. Beqaret do ndihen gati për t'ia shprehur ndjenjat atij qe kane koke qe e pëlqejnë dhe jete shume shpejt do ju ndryshojë. Buxhetin do dini si ta menaxhoni ne çdo moment dhe gjendja ka për te mbetur e kënaqshme. Vazhdoni me këtë strategji.

BRICJAPI

Sot do keni me shume nevojë se kurrë për qetësi dhe dashuri. Partneri do ju mbaje në pëllëmbë te dorës dhe do ju beje te ndiheni se me se miri. Beqaret kane për te pasur një dite fantastike. Ata do takojnë persona te shenjes se Luanit me te cilët do dashurohen koke e këmbë. Buxheti do varet nga mënyra sesi ju do i menaxhoni te ardhurat. Po nuk treguat kujdes do keni probleme.

BINJAKËT

Ata qe janë ne një lidhje ose janë te martuar kane për te kaluar një dite fantastike sot. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi do jete për t'u pasur zili nga te gjithë. Beqaret do kërkojnë me kot një lidhje te qëndrueshme. Fati nuk do jete gjithë kohës ne anën e tyre. Ne planin financiar bëjini me kujdes llogaritë dhe gjendja ka për te mbetur gjithë kohës e qëndrueshme.

PESHORJA

Jeta juaj ne çift nuk do ketë asnjë lloj problemi sot. Do ruani një kime te ngrohte me partnerin dhe do bashkëpunoni për çdo gjë me njeri-tjetrin. Beqaret do mundohen gjithë kohës, por nuk do arrijnë dot ta bëjnë për vete atë qe pëlqejnë. Me financat duhet te merreni me shume. Po i lare gjerat pas dore dhe po shpenzuar pa menduar për te ardhmen situata do ju dale jashtë kontrollit.

UJORI

Shtyrëzjozi sa te mundni ditën e sote me te dashuruarit dhe bëni çfarë t'u duket e arsyeshme. Marrëdhënia ne çift do mbetet gjithë kohës e mire. Beqaret nuk do duan te fillojnë një lidhje sepe do mendojnë sikur do humbin lirinë dhe pavarësinë. Plutoni do ketë ndikim pozitiv tek financat dhe gjendja do mbetet gjithë kohës e mire. Nuk do keni për çfarë te ankoheni.

GAFORRJA

Venusi do jete i pozicionuar me se miri ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Do merreni vesh me se miri me atë qe keni ne krah dhe mund te merreni edhe disa vendime. Beqaret do jene ne humor te mire dhe do i pranojnë te gjithë ftesat qe do ju bëhen. Financat do fillojnë te përmirësohen, pasi ju do dini si te luftoni për te arritur atë qe doni.

AKREPI

Dialogu, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi do mbizotërojnë gjate gjithë kohës ne jetën tuaj ne çift. Nuk do keni aspak probleme me partnerin dhe kjo do ju beje te ndiheni te qete. Beqaret do kenë me shume fat se kurrë dhe do e gjejnë princin e tyre te kaltër. Ne planin financiar do keni mbështetjen e planetëve dhe gjendja do vazhdoje te mbetet gjithë kohës e mire.

PESHQIT

Hëna do ju beje me pasionante sot ju te dashuruarve. Do e mahnitni atë qe keni ne krah dhe ai do ndiheni për mrekulli pranë njeri-tjetrit. Beqaret nuk do preferojnë te fillojnë një lidhje sot dhe do i refuzojnë te gjitha ftesat qe do ju bëhen. Ky do jete një gabim i rende. Ne planin financiar duhet ta dyfishoni maturinë dhe për çdo shpenzim duhet t'i bëni llogaritë mire.

PËRGJIGJE

S	H	U	M	A	L	A	K	I	M	E	T
T	H	O	N	I	H	A	B	A	N	E	R
M	N	S	T	E	R	E	T	E	L	A	K
G	H	E	M	E	L	E	T	E	L	A	K
F	R	E	N	A	N	A	N	T	E	K	A
M	O	T	R	A	T	E	M	M	U	R	I
N	M	I	T	O	A	M	A	M	B		
A	M	I	M	I	K	A	H	A	C		
P	K	I	K	A	M	U	R	I	R	E	
I	E	C	A	T	A	T	U	R	K	P	
A	T	A	K	M	B	I	R	K	A		
F	P	U	B	L	I	C	I	S	T	E	T

SHKRONJA
E NJËTË
PËR NUMËR
TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

5	K	3	E	1	P	4	2	1	6	3	10	2	3
1	2	9	8		11	1	12		2	3	6	6	
11	3	6		13	3	11	1	2	4	2	4	2	
4	7		13	3	7	3	2	4	5	3		9	
2		5	9	8	4	2	3	2	3	2		10	
1	11		2	1	11	3	2		2		12		
6	3	5		2	3	2		2	1	11	1	2	
4	7	9		9	16		5	1	2	4	6	4	
17	11		3	8	4	6	3				17	6	2
2	1		11	1	2	3	10	2	1	2		7	
	7	1	17	2	3			9	13	1	7	1	
16	1	17	13					16	4	2	1	2	3

Alba MALLTEZI - DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ; Aurel PEPA - KRYEREDAKTOR
GENC KONDI- ADMINISTRATOR I SHËRGJITHSHËM; Admira PEÇI- KRYEREDAKTORE E "RILINDASI";

DESIGN: ALTIN ALIAJ, Erjon YMERI, SHËRPERDARJA: Spiro MESHINI CEL: +35569608847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: shqiptarja.com@hotmail.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjen: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

Departamenti i Marketingut:
Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Surpriza e Sezonit Turistik 2016

NA VIZITONI



BUNK'ART

Ekspozita video-muzeale brenda ish-bunkerit anti-bërthamor
të ushtrisë shqiptare



www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime:

+355 (0) 67 20 72 905



Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut)
Tiranë - Albania

